



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË
ARSIMIN E LARTË**

**Raporti i Vlerësimit Periodik Institucional i
Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- | | |
|------------------------------|---------|
| 1. Elvin Gjevori, PhD, | Kryetar |
| 2. Prof. Arben Mehmeti, | Anëtar |
| 3. As. Prof. Besnik Krasniqi | Anëtar |

Tabela e Lëndës

Rreth vlerësimit	3
Konteksti i këtij vlerësimi	Error! Bookmark not defined.
Përmbledhje e raportit	4
Përmbledhje e gjetjeve	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	8
Dobësitë	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime	8
Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra	8
Gjykime përmbledhëse për çdo fushë vlerësimi	10
Gjykimi përmbledhës	Error! Bookmark not defined.
Raporti i plotë	10
Fusha e Vlerësimit 1: Organizata dhe Drejtimi i saj	11
Gjetjet	15
Praktika e mirë	Error! Bookmark not defined.
Dobësitë	17
Rekomandime	17
Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra	18
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	19
Gjetjet	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	Error! Bookmark not defined.
Dobësitë	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime	Error! Bookmark not defined.
Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra	Error! Bookmark not defined.
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	25
Gjetjet	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	Error! Bookmark not defined.
Dobësitë	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime	Error! Bookmark not defined.
Konfirmime	Error! Bookmark not defined.
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 4: mësimdhënia, të mësuarit, vlerësimi dhe kërkimi	29
Gjetjet	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	Error! Bookmark not defined.
Dobësitë	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime	Error! Bookmark not defined.
Konfirmim i veprimit të ndërmarrë	36
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe mbështetja për ta	37
Gjetjet	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	Error! Bookmark not defined.
Dobësitë	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime	Error! Bookmark not defined.
Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra	Error! Bookmark not defined.
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Lista e evidencave	Error! Bookmark not defined.
Lista A: Lista e dokumenteve	44
Lista B: Takimet e zhvilluara gjatë vizitës	48
Lista C: Lista e dokumenteve të ofruara gjatë vizitës	48

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Rishikimit Institucional është të vlerësojë shkallën në të cilën çdo IAL përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, të cilat kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Rishikimi institucional është një proces vlerësimi që kryhet nga kolegë të universiteteve të tjera. Çdo ekip vlerësimi ka në përbërjen e tij vlerësues ndërkombëtarë dhe shqiptarë që caktohen nga ASCAL-i.

Raporti që përgatishin vlerësuesit e jashtëm shërben jo vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'u ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të i përmbushin këto standarde. Ky raport ndihmon edhe vetë IAL-të që të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë dhe rrugëve për të ndihmuar studentët që të përvetësojnë njohuritë).

Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë janë grupuar në pesë seksione ose fusha vlerësimi: Organizata dhe Drejtimi i saj; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimi, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja për ta. Ky raport identifikon elementët e praktikës së mirë, rekomandimet, konfirmimin e veprimeve të ndërmarra dhe dobësitë për çdo fushë vlerësimi, së bashku me gjykimin për shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-ja. Gjykimet që mund të japin vlerësuesit janë: standardet përmbushen plotësisht, kryesisht, pjesërisht ose nuk përmbushen.

Në fund, vlerësuesit japin një gjykim të përmblodhur për Bordin e Akreditimit të ASCAL-it në formën e rekomandimit. Ky gjykim i përmblodhur është një nga katër nivelet:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur**

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (UAMD) është njëkohësisht universiteti më i ri publik në Shqipëri – themeluar në vitin 2005 me VKM-në nr. 801, datë 20.12.2005 – dhe universiteti më i madh publik që ndodhet jashtë kryeqytetit, Tiranë. Nga ky këndvështrim, ai pasqyron si tiparet e një universiteti të madh me qendër në Tiranë, ashtu edhe problemet me të cilat përballen institucionet rajonale të arsimit të lartë. Fillimisht i themeluar me tre fakultete dhe fokus në studimet profesionale, universiteti është rritur në pesë fakultete, me pothuajse 20,000 studentë (bazuar në vetëraportimet në ASCAL) dhe ka marrë gjithnjë e më shumë një profil më të plotë universitar duke ofruar diploma studimi në të tre ciklet e studimeve dhe duke luajtur një rol gjithnjë e më të sigurt në kërkime.

Universiteti përbëhet nga pesë fakultete: **(1) Fakulteti i Biznesit me 5 departamente, (2) Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike me 3 departamente, (3) Fakulteti i Edukimit me 6 departamente, (4) Fakulteti i Studimeve Profesionale me 3 departamente, (5) Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit me 3 departamente.** Universiteti ka pësuar disa riorganizime institucionale, më i fundit është në vitin 2021 kur Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën u kthye në departament brenda Fakultetit të Studimeve Profesionale. Në përgjithësi, fakultetet e UAMD-së ofrojnë programe të strukturuar studimi në të 3 ciklet e studimeve dhe janë të angazhuara në aktivitete kërkimore.

Gjatë rritjes së tij në mënyrë eksponenciale, universiteti ka zhvilluar një rrjet të gjerë marrëveshjesh bashkëpunimi ndërkombëtar dhe, aktualisht, nëpërmjet mbështetjes dhe udhëheqjes së qeverisë shqiptare, universiteti po ndërmerr hapa në drejtim të lidhjes së partneriteteve të ngushta institucionale me universitetet europiane, për të rritur nivelin e ndërkombëtarizimit si një tregues i cilësisë së tij akademike. Megjithatë, duke qenë se zhvillime të tilla ende nuk janë konkretizuar dhe nuk janë përfshirë në raportin e vlerësimit të brendshëm, ekipi i vlerësimit të jashtëm nuk është në gjendje të shprehë një opinion për to.

Përmbledhje e raportit

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (UAMD) është institucioni më i ri publik i arsimit të lartë në Shqipëri dhe më i madhi jashtë Tiranës. Të qenit më i ri do të thotë që UAMD-ja nuk vuan nga shumica e sëmundjeve institucionale që prekin IAL-të shqiptare të krijuara më herët, meqenëse që nga themelimi, UAMD-ja u bazua në standardet e konsoliduara europiane të arsimit të lartë, si kreditet e programeve, mobiliteti i studentëve, lidhja me tregun e punës, dhe autonomia akademike. Megjithatë, të qenit më i ri paraqet, gjithashtu, disa rreziqe, veçanërisht për sa i përket krijimit të një identiteti të spikatur akademik bazuar në atë që UAMD-ja “bën më mirë.” Në përputhje me ligjin, ky universitet është person juridik publik me seli në Lagjen Nr. 1, Rruga e Currilave, Durrës. Përveç kësaj, dhe po aq i rëndësishëm, është edhe fakti që UAMD-ja ka një kompleks kampusi menjëherë në dalje të qytetit të Durrësit, në Spitalë, ku kryhen shumica e aktiviteteve mësimore dhe kërkimore.

Universiteti është i organizuar në 5 fakultete dhe 21 departamente, 3 qendra kërkimore (vetëm njëra prej tyre shërben si departament brenda Fakultetit të Edukimit) dhe 37 njësi administrative. Sipas deklarimeve të UAMD-së në ASCAL, në momentin e vizitës në terren, universiteti ofronte gjithsej 101 programe studimi si më poshtë: 18 programe studimi profesionale, 42 programe studimi bachelor, 25 programe studimi master profesional, 19 programe studimi master shkencor dhe 1 program doktore. Të gjitha programet e studimit

përdorin Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Aktualisht, UAMD-ja ka 306 punonjës akademikë (224 me kontrata të përhershme, 78 me kontrata për periudha të caktuara dhe 4 të emëruar/komanduar). Universiteti, siç e kërkon ligji, ka aplikuar për riorganizimin e programeve të doktoraturës dhe grupi i vlerësuesve u informua se pritet miratimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) për të filluar regjistrimin e studentëve të rinj të doktoraturës.

Ajo që është pozitive dhe ndryshe nga shumica e universiteteve të tjera publike, UAMD-ja ka pasur një rritje konstante, siç pasqyrohet nga numri i studentëve. Kjo ka bërë të mundur që universiteti të zgjerojë “ofertën” e tij akademike pa u përballur me “erërat e kundërta” me të cilat përballen universitetet e tjera, veçanërisht ato rajonale. Ky zhvillim pozitiv duhet të përdoret nga UAMD-ja për t’u përgatitur më mirë për të ardhmen, pasi tendencat dhe parashikimet aktuale demografike tregojnë se në një moment edhe ai mund të përballlet edhe me këtë problem.

Ky është vlerësimi i dytë institucional i universitetit për të përcaktuar shkallën e përbushjes së standardeve të cilësisë të shtetit shqiptar. Raporti i vlerësimit të parë institucional në dhjetor 2016 identifikoi **6** elementë të praktikës së mirë, **1** dobësi, bëri **1** rekomandim për universitetin dhe konfirmoi **1** veprim të ndërmarrë.

Raporti i fundit i vlerësimit të jashtëm institucional (2016) regjistroi gjykimet e mëposhtme për secilën fushë vlerësimi:

1. Standardet për Organizatën dhe Strukturat Drejtuese të saj **janë përbushur kryesisht.**
2. Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht.**
3. Standardet e kurrikulës janë **përbushur plotësisht.**
4. Standardet për mësimdhënien, të mësuarit, vlerësimin dhe kërkimin **janë përbushur plotësisht.**
5. Standardet për studentët dhe mbështetjen për ta janë **përbushur plotësisht.**

Në dhjetor 2016, vlerësuesit i raportuan Bordit të Akreditimit se në **Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës**, standardet shtetërore të cilësisë ishin **përbushur plotësisht** dhe për këtë arsye Bordi i Akreditimit i dha universitetit akreditimin për një **periudhë katërvjeçare**.

Bazuar në Manualin e Procedurave të Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), UAMD-ja filloi procesin e vetëvlerësimit - si përgatitje për rishikimin periodik të akreditimit institucional - i cili u drejtua nga një grup i brendshëm pune për vetëvlerësimin i përbërë nga gjashtë anëtarë të stafit me njohuri të thella për universitetin dhe një përfaqësues i studentëve. Grupi i punës u krijua nga Senati Akademik, u pajis me dokumentet e brendshme, statutet dhe rregulloret e universitetit së bashku me të gjitha të dhënat dhe raportet përkatëse statistikore. Grupit, gjithashtu, iu vunë në dispozicion rekomandimet e Bordit të Akreditimit pas shqyrtimit në vitin 2016. Draftet u qarkulluan në një audiencë më të gjerë brenda universitetit përpara se të finalizoheshin. Senati Akademik autorizoi publikimin e raportit përfundimtar dhe dorëzimin e tij zyrtarisht në ASCAL.

Vizita e grupit të vlerësimit të jashtëm u zhvillua gjatë dy ditëve në datat **21 dhe 22 tetor 2021**. Ekipi i rishikimit përbëhej nga tre vlerësues, një nga Shqipëria (drejtues) dhe 2 nga Kosova. Ekipi i rishikimit u mbështet nga menaxheri i rishikimit i ofruar nga ASCAL-i. Ekipe të rishikimit

iu vunë në dispozicion raporti i vetëvlerësimit dhe të gjitha dokumentet e nevojshme përpara vizitës në terren, dhe gjatë vizitës u bënë plotësime me dokumentacion shtesë që u kërkua nga grupi i vlerësimit të jashtëm si para dhe gjatë vizitës.

Informacioni mbështetës i ofruar nga UAMD-ja i dha mundësi ekipit të njihej me strukturën, politikat, procedurat e menaxhimit dhe natyrën e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore që zhvillohet në UAMD. Dokumentet përfshinin statutin dhe rregulloret, raportet e brendshme, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve dhe memorandumëve me jashtë, shembuj të informacionit që ofrohej për programet, si dhe evidencat e rezultateve të punës kërkimore.

Gjatë vizitës së rishikimit, ekipi u takua me drejtues të lartë të universitetit, studentë, pedagogë, personel administrativ dhe mbështetës, si dhe alumni dhe partnerë të jashtëm. Shkëmbimi dhe diskutimet ndihmuan në qartësimin e procedurave, përgjegjësi dhe gjetjeve. Në të gjitha takimet u mbajtën shënime. Në kuadrin e rishikimit, në kampusin universitar u realizuan vizita në të gjitha mjediset e mësimdhënies, të punës kërkimore dhe të të mësuarit në njësitë/hapësirat e përcaktuara nga grupi i vlerësimit. Siç do të bëhet e qartë përmes raportit, ekipi i rishikimit ka bërë shumë rekomandime. Këto rekomandime nuk duhen parë në mënyrë të ngurtë, si kufizime të universitetit, por më tepër si hapa që duhen ndërmarrë në të ardhmen për të forcuar më tej UAMD-në.

Ekipi i rishikimit mund të konfirmojë sa vijon në lidhje me hapat e ndërmarrë nga UAMD-ja për të trajtuar dobësitë dhe rekomandimet përkatëse të identifikuara nga procesi i vlerësimit të jashtëm 2016:

- I) Për sa i përket rekomandimit për përmirësimin e komunikimit të vendimeve dhe analizave të niveleve të larta drejtuese të universitetit tek të gjithë aktorët e interesuar dhe të përfshirë, grupi i vlerësimit konstaton se ai është përmbushur pasi të gjitha vendimet e Senatit Akademik dhe të Rektoratit diskutohen së brendshmi, qarkullohen pas përfundimit dhe ndiqen nga strukturat përkatëse të ngarkuara me zbatimin e tyre;
- II) Lidhur me rekomandimin që universiteti të ndërmarrë një fushatë të bashkërenduar për të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me palët e treta me qëllim që studentët të kenë mundësi të zhvillojnë në mënyrë efektive praktikën mësimore dhe stazhet, ekipi i rishikimit konstaton se është bërë përparim thelbësor dhe i lavdërueshëm pasi janë nënshkruar 32 marrëveshje të reja që garantojnë efektivitetin e praktikave të mësimdhënies. Por grupi i rishikimit e shikon të rëndësishme të ritheksojë se kjo është një çështje që “nuk zgjidhet kurrë plotësisht” dhe UAMD-ja duhet të vazhdojë përpjekjet për të forcuar kontaktin me palët e treta dhe për të konsoliduar partneritetet e tij me aktorët e tregut të punës në zonën e Durrësit dhe më gjerë;
- III) Lidhur me rekomandimin që universiteti të shkojë përtej vlerësimit të thjeshtë të mësimdhënies dhe kënaqësisë së studentëve, por edhe të zgjidhë problemet dhe çështjet e identifikuara përmes vlerësimeve përkatëse, grupi i rishikimit konstaton se vlerësime të tilla janë pjesë e rregullave të reja që janë miratuar dhe që i përfshijnë rezultatet e anketimeve në vlerësimin e përgjithshëm të stafit të UAMD-së në fund të vitit. Siç do të bëhet e qartë përmes raportit në

vijim, ekipi i rishikimit beson, gjithashtu, se tani është koha për të shkuar edhe përtej këtij standardi, drejt institucionalizimit të trajnimit të stafit dhe përmirësimit të vazhdueshëm, i cili, ndër të tjera, bazohet dhe reflekton gjetjet e vlerësimit të mësimdhënies dhe kënaqësisë së studentëve;

IV) Lidhur me rekomandimin që universiteti të përdorë në mënyrë më efektive informacionin e mbledhur nëpërmjet anketave të studentëve dhe burimeve të tjera si instrument për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, grupi i rishikimit konstaton se është bërë progres thelbësor dhe i lavdërueshëm. Meqenëse ky është një "cikël i pafund" - cilësia e mësimdhënies nuk arrihet kurrë plotësisht dhe përgjithmonë - grupi sërish inkurajon institucionin të vazhdojë përpjekjet në këtë drejtim, çka do të qartësohet më tej nga disa prej rekomandimeve tona në këtë raport;

V) Lidhur me rekomandimin që universiteti të caktojë në çdo ndërtesë hapësira të dedikuara për shërbimet ndaj studentëve përtej atyre të dedikuara për mësimdhënien dhe mësimnxënies, grupi i rishikimit konstaton se, me shtimin e dy ndërtesave në kampusin e Spitalës, është bërë përmirësim i madh dhe domethënës në këtë aspekt. E rëndësishme është që studentët konfirmuan sërish dëshirën e tyre për më shumë hapësira kushtuar 'socializimit' gjatë qëndrimit në universitet, ndaj inkurajojmë UAMD-në që, brenda hapësirës që zotëron tani, të krijojë disa zona të dedikuara për socializim, të cilat favorizojnë një jetë studentore më të përmbushur dhe më të pasur.

- ***Në përgjithësi, ekipi i rishikimit konstaton se rekomandimet e Bordit të Akreditimit janë përmbushur si në shkronjë ashtu edhe në frymë. Grupi i rishikimit e konsideron të rëndësishme dhe inkurajon UAMD-në të vazhdojë përpjekjet në këto drejtime, pasi shumica e çështjeve të sipërpërmendura janë periodike dhe kërkojnë vëmendje dhe financim të vazhdueshëm.***

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Ekipi i rishikimit identifikoi elementët e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Plani Strategjik i UAMD-së 2020 – 2022 shoqërohet me dokumentin e Planifikimit të Aktiviteteve Strategjike 2021-2023, i cili përvijon piketat, produktet, afatet kohore dhe njësitë përgjegjëse. Kjo është një praktikë e mirë që duhet të zgjerohet për të gjitha dokumentet e tjera strategjike pasi mundëson ndjekjen dhe llogaridhënien **[Kapitulli III Standardi I.5]**.
- Bashkëpunimi i strukturuar i UAMD-së me *Crystal Systems Group* me qendër në Qipro është një praktikë e mirë që mundëson përmirësimin e mësimdhënies, pasurimin e instrumenteve didaktike dhe integrimin e pandërprerë të studentëve në tregun e punës **[Kapitulli III Standardi III.1]**.
- Hartimi i strukturuar i programeve të studimit nga UAMD-ja bazuar në nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet ndërkombëtare, nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët e biznesit dhe donatorët ndërkombëtarë, është një praktikë e mirë që duhet zgjeruar dhe institucionalizuar më tej. **(Kapitulli I Standardi I.4)**
- UAMD-ja ofron kurse ndërkombëtare online për studentët e tij bazuar në një marrëveshje bashkëpunimi me platformën universitare “Coursera” **[Kapitulli I Standardi III.5]**.
- Hapat e UAMD-së për përballimin e COVID-19 kanë qenë inkurajuese, veçanërisht përdorimi i *Google Meet and Muddle*, për të lehtësuar mësimdhënien dhe të mësuarit në internet. UAMD-ja duhet të vazhdojë të përdorë mjetet online për të plotësuar mësimdhënien edhe gjatë periudhës pas pandemisë së Covid-19. **[Kapitulli III, Standardi VII.2]**

Dobësitë

Ekipi i rishikimit identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- UAMD-ja ka mungesë të projekteve kërkimore me financim të sigurt – përveç mbështetjes për pjesëmarrjen në konferenca dhe tarifat e publikimit – gjë që e pengon të ndërmarrë kërkime me cilësi të lartë që finalizohen me botimin e artikujve shkencorë në revista me faktor impakti. **[Kapitulli I Standardi II.4 dhe Kapitulli II Standardi I.1]**

Rekomandime

Ekipi i rishikimit identifikoi rekomandimet e mëposhtme:

- Dokumentet e UAMD-së – veçanërisht statuti dhe organigrama – duhet të pasqyrojnë riorganizimin e fundit që ka bërë institucioni. Në funksion të kësaj, aty ku e kërkon ligji, brenda vitit akademik 2021 – 2022, UAMD-ja duhet të sigurojë miratimin nga ministria

përgjegjëse për arsimin e dokumenteve të rishikuara që pasqyrojnë këtë riorganizim. **[Kapitulli III Standardi I.1; Kapitulli III Standardi I.4].**

- UAMD-ja duhet të hartojë dhe zbatojë një plan veprimi të strukturuar - me piketa dhe afate konkrete - për rritjen e numrit të studentëve që përfitojnë nga mobilitetet ndërkombëtare **[Kapitulli I Standardi III.8].**
- Qendra për Kërkim dhe Ekselencë e UAMD-së duhet të jetë 'e përshtatshme për qëllimin' duke pasur staf të përshtatshëm – të ekuilibruar si në numër ashtu edhe në në përbërje sa i takon stafit administrativ dhe atij akademik - për të garantuar realizimin e detyrave të renditura në dokumentin e Planifikimit të Aktiviteteve Strategjike 2021-2023, por edhe në të tjera dokumente kryesore. **[Kapitulli III Standardi I.5]**
- UAMD-ja duhet të krijojë një bazë të dhënash të strukturuar dhe të përditësuar të të diplomuarve, përmes së cilës të gjurmohet zhvillimin e tyre profesional dhe statusin e punësimit. Për më tepër, UAMD-ja duhet të organizojë takime periodike dhe të zgjerojë komunikimin me të diplomuarit përmes aktiviteteve të reja përveç atyre që ka përdorur deri tani. **[Kapitulli I Standardi III.1]**
- Vlerësimi i performancës së stafit nga UAMD-ja duhet të përfshijë më shumë kriterë për botimin në revista me faktor impakti dhe duhet të shoqërohet me buxhet për zhvillimin e stafit duke u fokusuar në financimin e projekteve kërkimore. **[Kapitulli III Standardi IV.3]**
- Strategjia financiare e UAMD-së duhet të fokusohet në diversifikimin e burimeve të saj financiare. Në këtë drejtim, ekzistojnë mundësi për komercializimin e disa prej aktiviteteve kërkimore ose rritjen e financimit nga projektet/donatorët dhe/ose kompanitë private. **[Kapitulli III. Standardi VI.1]**
- UAMD-ja duhet të inkurajojë studentët dhe stafin akademik që të përdorin më shumë burime elektronike, veçanërisht duke e bërë përdorimin e këtyre burimeve të detyrueshëm për studentët në detyrat që u jepen. **[Kapitulli III, Standardi VII.2]**
- UAMD-ja duhet të përditësojë versionin anglisht të faqes në internet, veçanërisht gjatë këtij momenti të rëndësishëm për ndërkombëtarizimin e tij. **[Kapitulli III, Standardi VII.2]**
- UAMD-ja duhet të publikojë në internet çdo syllabus për të gjitha programet e tij të studimit për t'u dhënë mundësi stafit, studentëve dhe studentëve të ardhshëm të njihen me këtë informacion. **[Kapitulli I Standardi I.6]**
- UAMD-ja duhet të vlerësojë periodikisht treguesit kryesorë të performancës, siç janë numri i regjistrimeve të reja, numri total i studentëve, numri i atyre që ndërpresin studimet, numri i të diplomuarve, lista e publikimeve, numri i botimeve për çdo profesor si dhe ta pasqyrojë këtë vlerësim në hapat përkatëse që ndërmerr. **[Kapitulli I Standardi II.1]**
- Stafi akademik i UAMD-së duhet të reflektojë mbi rezultatet e pyetësorëve të studentëve dhe t'u japë studentëve opinionin e vet të strukturuar në lidhje me to. **[Kapitulli I Standardi II.3]**
- UAMD-ja duhet të rrisë aplikimet për projekte kërkimore në kuadrin e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare për të rritur numrin e projekteve kërkimore

ndërkombëtare si dhe përfshirjen e studiuesve dhe studentëve të rinj. **[Kapitulli II Standardi I.1, I.6 dhe I.7]**

- UAMD-ja duhet të organizojë seminare periodike për stafin dhe studentët me fokus ndërgjegjësimin për plagjiaturën. **[Kapitulli II Standardet I.7]**
- UAMD-ja duhet të rrisë numrin e vendeve në bibliotekën kryesore në mënyrë që studentët të kenë hapësirë të mjaftueshme për të lexuar **[Kapitulli I Standardi III.6]**
- UAMD-ja duhet të monitorojë proceset e konsultimit (pedagog – student) sa i takon numrit të studentëve që kërkojnë ndihmë çdo javë, kohëzgjatjen e konsultimit dhe efektin konkret në rezultatet e studentëve. **[Kapitulli I Standardi III.1 dhe Kapitulli I Standardi III.6]**
- UAMD-ja duhet të përfshijë në mënyrë më proaktive studentët në vendimmarrje dhe t'i informojë ata për rolin vendimtar që kanë në qeverisjen e universitetit. **[Kapitulli I Standardi III.7]**

Bazuar në përgjigjen e UAMD-së për draft raportin e vlerësimit të jashtëm, dërguar ASCAL-it me shkresën përcjellëse Prot. 1725/1 Nr., datë 07.12.2021, ekipi i rishikimit dëshiron të vërë në dukje hapat proaktivë të universitetit për trajtimin e disa prej rekomandimeve të përfshira në këtë draft raport. Ekipi e përgëzon UAMD-në për proaktivitetin e tij dhe e inkurajon që të vazhdojë në këtë frymë.

Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra

Ekipi i rishikimit konfirmon veprimet e mëposhtme në proces:

- UAMD-ja është në fazat përfundimtare të nënshkrimit të një marrëveshjeje me Universitetin e Nicës, Francë, për ofrimin e diplomave të dyfishta **[Kapitulli III Standardi III.4]**.
- Rritja e planifikuar me 75% e buxhetit të UAMD-së për projekte të vogla kërkimore, për të cilat mund të aplikojnë departamentet, është një zhvillim pozitiv që duhet të pasohet nga rregullorja përkatëse në mënyrë që ky proces të institucionalizohet **[Kapitulli II Standardi I.1]**
- Mbështetja e drejtpërdrejtë e UAMD-së për stafin akademik të angazhuar në botimin e artikujve kërkimor në revista me faktor impakti është një praktikë pozitive që ka potencialin të rrijnë një klimë të shëndetshme akademike **[Kapitulli II Standardi I.1]**
- Organizimi i “Panairit të Punësimit” është një praktikë e mirë, e cila u jep mundësi studentëve të integrohen më mirë në tregun e punës **[Kapitulli I Standardi III.5]**

Përmbledhje e gjykimeve për secilën fushë të vlerësimit

1. Standardet për organizatën dhe drejtimin e saj **janë përmbushur plotësisht;**
2. Standardet për burimet **janë përmbushur plotësisht;**
3. Standardet për kurrikulën **janë përmbushur plotësisht;**
4. Standardet për mësimdhënien, të nxëniet, vlerësimin dhe kërkimin shkencor **janë përmbushur kryesisht;**
5. Standardet për studentët dhe mbështetjen e tyre **janë përmbushur plotësisht.**

Gjykimi përmbledhës

Rishikuesit i rekomandojnë Bordit të Akreditimit se në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, janë përmbushur plotësisht Standardet Shtetërore të Cilësisë.

Raporti i hollësishëm

Fusha e vlerësimit 1: Organizata dhe drejtimi i saj

1.1 Nëpërmjet raportit të vetë-vlerësimit të institucionit (RVV), dokumenteve mbështetëse të bashkangjitura, si dhe gjatë vizitës dyditore në terren, UAMD-ja i ofroi grupit të vlerësimit të jashtëm prova thelbësore për të vërtetuar në mënyrë të kënaqshme ekzistencën dhe funksionimin e mekanizmave institucionalë të mirëpërcaktuar për menaxhimin dhe organizimin e UAMD-së **[A.E1 deri A.E21]**. Në përgjithësi, grupi vlerësues konstaton se Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës, (UAMD) zbaton dispozitat e ligjit nr.80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe funksionon si institucion publik i arsimit të lartë duke respektuar parimet e lirisë akademike dhe autonomisë financiare të shprehura në statutin e tij. **[A.E1 Statuti i UAMD-së, neni 1 pika 1, neni 2 pika 1, neni 3 dhe 5]**.

Pa hyrë në detaje të panevojshme, ekipi i rishikimit do të nxjerrë në pah disa nga strukturat më të rëndësishme të UAMD-së nga pikëpamja organizative. Organet kolegjiale drejtuese të UAMD-së janë: Senati Akademik **[A.E27]**, Bordi i Administrimit **[A.E28]**, Asambleja e Stafit Akademik **[A.E1 Statuti i UAMD-së, neni 25]** dhe komisionet e përhershme **[A.E26]**. Organet e tjera kolegjiale të drejtimit të universitetit janë Rektorati, Këshilli i Etikës dhe këshillat e fakulteteve **[A.E1 Statuti i UAMD-së, neni 20 dhe 22]**. Autoritetet ekzekutive të universitetit përbëhen nga rektori, dekanët dhe drejtuesit e departamenteve **[A.E1 Statuti i UAMD-së, nenet 18, 27 dhe 29]**. Rregullorja e UAMD-së është e konceptuar mirë dhe rregullon me qartësi organizimin dhe proceset vendimmarrëse të universitetit në lidhje me procesin akademik **[A.E2 Rregullorja e UAMD-së, Kapitulli 2, nenet 10 deri në 39]**. E rëndësishme është se përveç dokumenteve për të gjithë institucionin, UAMD-ja ka krijuar edhe rregullore të brendshme funksionale dhe strategji kërkimore në nivel fakulteti **[A.E3.2 Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Edukimit]**.

Bazuar në dokumentet e sipërpërmendura, si dhe në pasqyrim të strukturës dhe rregullores së universitetit, UAMD-ja ka hartuar një strukturë organizative/organigramë shumë logjike ku identifikohen të gjitha strukturat institucionale dhe marrëdhëniet hierarkike brenda universitetit **[A.E1 deri në 3.5]**, e cila ndër të tjera, hyn në zbatim në zgjedhjet periodike dhe të hapura të rektorit, dekanëve dhe drejtuesve të departamenteve si dhe në periudhën midis dy zgjedhjeve nga asambltetë e fakulteteve që dalin nga zgjedhjet përkatëse **[A.E1 Statuti i UAMD-së, neni 5 pika 4, nenet 18, 27 dhe 29]**. **[Kapitulli III Standardi I.1]**.

1.2 Bazuar në parimin e konsoliduar të autonomisë dhe subsidiaritetit ‘të brendshëm’, shumica dërrmuese e vendimeve të rëndësishme që ndikojnë në jetën akademike, si hartimi dhe rishikimi i programeve të studimit dhe kurrikulave, shpërndarja e burimeve për mësimdhënie dhe në një masë të caktuar edhe për punë kërkimore, prioritetet dhe drejtimit e përgjithshme, planet e mësimdhënies dhe bashkëpunimi me palët e treta, nisin dhe formësohen fillimisht në nivel departamenti dhe më pas në nivel fakulteti **[A.E2 Rregullorja e UAMD-së, Kapitulli 3, nenet 40 deri në 90]**. UAMD-ja ka kryer së fundmi një riorganizim institucional për të përmbushur kërkesat ligjore, gjë që është reflektuar edhe në ndryshimet e propozuara në statut. Edhe pse grupit të rishikimit iu dorëzua statuti i rishikuar **[C.13]** pasi e kërkoi në mënyrë të posacme, me sa konstatojmë, procesi nuk është finalizuar ende plotësisht pasi statuti i rishikuar

nuk është miratuar zyrtarisht nga ministria. **Është e rëndësishme që ky proces të përfundojë pa vonesë.** Është interesante se ky proces, pavarësisht rëndësisë, nuk iu përmend ekipit të vlerësimit gjatë vizitës në terren, dhe nuk përmendet as në RVV. Kjo mund të jetë një shenjë se procesi i riorganizimit mund të mos ketë qenë gjithëpërfshirës dhe se komunikimi i brendshëm mund të mos ketë qenë shumë efektiv. Për të siguruar që mospërputhje të tilla të shmangen në të ardhmen, udhëheqja e universitetit duhet të sigurojë që 1) të finalizohen të gjithë hapat e kërkuar ligjërisht të procesit të riorganizimit dhe 2) të gjithë aktorët përkatës të jenë të vetëdijshëm për procesin dhe tërësinë e hapave që e përbëjnë atë. **[Kapitulli III Standardi I.1; Kapitulli III Standardi I.4].**

- 1.3 Për sa i përket menaxhimit financiar, 'arka' e universitetit menaxhohet nga Bordi i pavarur i Administrimit **[A.E1 Statuti i UAMD-së, neni 32]** një nga përfaqësuesit e të cilit zgjidhet nga studentët **[A.E29]**. Bordi i Administrimit mbikëqyr të gjitha funksionet ekonomike dhe administrative të UAMD-së, të cilat janë të ndara nga drejtimi akademik i universitetit **[A.E1 Statuti i UAMD-së, neni 33 dhe 34]**. Buxheti i universitetit dukej se hartohej në mënyrë gjithëpërfshirëse, fillohej në nivel departamenti dhe gjatë rrugës përfshinte të gjithë aktorët përkatës **[A.E32 dhe A.E33]**. Po aq e rëndësishme: siç i tha Rektori grupit të rishikimit **[BM2]**, UAMD-ja është e vetëdijshme se universiteti është shumë i varur nga buxheti i shtetit dhe tarifrat e studentëve për veprimtarinë e tij, prandaj ka filluar procesin e identifikimit të rrugëve për të diversifikuar burimet e fondeve.

Identifikimi i nevojave dhe planifikimi i aktiviteteve kryesore fillon në nivel departamenti, miratohen në nivel fakulteti, më pas në nivel rektorati dhe finalizohen në nivel senati **[BM2 dhe BM11]**. Gjatë takimeve të ndryshme ne u informuam se procesi është efikas pasi universiteti është rritur në mënyrë gjithëpërfshirëse ndër vite dhe pesë fakultetet e tij kanë nevoja që nuk bien ndesh me njëra-tjetrën **[BM6]**. E rëndësishme: Bordi i Administrimit dukej se ishte i hapur dhe mirëpriste qasjen e universitetit në marrjen e vendimeve financiare dhe dukej se ishte i gatshëm të ndërmerre hapat e nevojshëm për të siguruar qëndrueshmërinë financiare dhe rritjen e performancës së universitetit **[BM10]**.

Nga këndvështrimi strukturor, të gjitha organet vendimmarrëse që varen nga buxheti dhe furnizojnë atë me të dhëna, janë ngritur dhe funksionojnë mirë sipas rregullave në UAMD. Rektori, dekanët dhe drejtuesit e departamenteve zgjidhen në mënyrë të rregullt për një mandat katërvjeçar, siç parashikohet në ligj. Studentët, personeli akademik dhe joakademik mund të marrin pjesë në zgjedhjet për autoritetet drejtuese të universitetit. E rëndësishme është se studentët përfaqësohen edhe në Senatin Akademik **[A.E1 Statuti i UAMD-së, neni 14 pika 5 dhe neni 18 pika 4]**. Në zgjedhjet e fundit për postet e larta ka pasur drejtësi dhe transparencë në përputhje me rregulloren e zgjedhjeve të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Së fundi, dhe më e rëndësishmja, UAMD-ja ka një këshill të etikës që vlerëson dhe rregullon sjelljen etike të stafit si dhe komisionet e përhershme për i) sigurimin e cilësisë dhe ii) promovimin e personelit akademik **[A.E1 Statuti i UAMD-së, neni 23 dhe 23]**. **[Kapitulli III Standardi I.2].**

- 1.4 Gjatë takimeve që patëm në UAMD me të gjithë aktorët, vumë re një frymë të hapur diskutimi konstruktiv. Senati Akademik mblidhet periodikisht të paktën një herë në muaj për të diskutuar dhe marrë vendime bazuar në një agjendë të rënë dakord paraprakisht, e cila u dërgohet të gjithë aktorëve të interesuar **[RVV. f 13-14]**.

Megjithatë, ne vumë re një frymë jo dhe aq mirëpritëse ndaj pyetjeve për çështje të ndryshme të ngritura nga ekipi i rishikimit. Është e kuptueshme që personeli i UAMD-së të mbrojnë punën e vet, por është njëkohësisht e këshillueshme, dhe në të vërtetë dhe inteligjente, që të jenë mendjehapur dhe të mirëpresin këndvështrime të ndryshme nga jashtë, pa qenë nevoja të vihen në pozita mbrojtjeje. Universiteti është dhe duhet të jetë një mjedis për debate ideore.

Në përgjithësi, ka disa organe të ndërmjetme që ndihmojnë në monitorimin efikas të shërbimeve në UAMD dhe në formësimin e debatit konstruktiv. Në mënyrë të veçantë, universiteti ka tre zëvendësrektorë që mbulojnë fushat e caktuara të përgjegjësisë dhe disa zyra administrative që i ndihmojnë ata [RVV, f. 14]. Disa nga këto zyra, veçanërisht 2 qendrat kërkimore, **duket se kanë mungesë të personelit** për detyrat që u janë caktuar. Në përgjithësi, ekipi i rishikimit konfirmon se universiteti ka organe/instrumente kolegiale dhe ekzekutive që bëjnë të mundur zbatimin e politikave të tij dhe monitorimin e efektivitetit të tyre brenda kufijve të autonomisë. **[Kapitulli III Standardi I.3; Kapitulli III Standardi II.3].**

- 1.5 Rektorati, nën drejtimin e rektorit, është përgjegjës për hartimin e planit strategjik të zhvillimit të universitetit. Plani aktual i Zhvillimit Strategjik 2020-2025 përcakton qartë objektivat dhe arsyen e ekzistencës së universitetit, ndërkohë që kodifikon misionin dhe qëllimin e përgjithshëm të UAMD-së **[A.E4 Plani Strategjik i Zhvillimit të UAMD-së]**. Ekipi i rishikimit konstatoi se *Plani Strategjik i UAMD-së 2020-2025* ka një vizion strategjik, strategji të përcaktuara mirë, perspektivë të zhvillimit institucional dhe fokus të qartë në sigurimin e cilësisë, ndër të tjera. Një tjetër anë pozitive është se plani shoqërohet nga dokumenti i Planifikimit të Aktiviteteve Strategjike 2021-2023 **[A.E5]**, i cili paraqet në mënyrë të detajuar dhe koherente të gjitha hapat specifikë dhe aktorët përgjegjës për to. Planifikimi i aktiviteteve strategjike, afatet kohore të përcaktuara qartë dhe identifikimi i zyrave/njësive përgjegjëse për zbatimin e tyre mundëson ndjekjen dhe linja të qarta ekzekutuese dhe, si i tillë, në këndvështrimin tonë, është një element i praktikës së mirë. Në të gjithë këtë proces ishte e qartë se vizioni dhe lidhshëria e Rektorit kishin krijuar një mjedis gjithëpërfshirës që u jepte jetë parimeve dhe mekanizmave të këtyre dokumenteve. E rëndësishme: u informuam edhe nga Rektori **[MB2]** se, në përputhje me politikën e qeverisë, UAMD-ja ishte në proces finalizimi të një marrëveshjeje me një universitet francez për dhënien e diplomave të dyfishta.

Pas një shqyrtimi më nga afër të dokumentit të Planifikimit të Aktiviteteve Strategjike 2021-2023 të UAMD-së **[A.E5 fq. 9-10]** ishte e qartë se, një nga zyrat e ngarkuara me zbatimin e elementëve të rëndësishëm të këtij plani, ishte Qendra për Kërkim dhe Ekselencë. Interesante është, megjithatë, se në strukturën organizative të universitetit, kjo Qendër ka vetëm dy punonjës, një drejtor dhe një specialist **[A.E12]**. Në takimet e ndryshme që patëm me rektorin, bordin e administrimit dhe drejtuesit e lartë të universitetit, ne e ngritëm këtë çështje, por u krijua përshtypja se kjo është një zyrë për të cilën nuk është arritur ende mirëkuptimi për mënyrën e organizimit dhe tipologjinë që do të duhet të ketë, përkatësisht administrative apo akademike. Grupi i rishikimit e lë në diskrecionin e universitetit që të vendosë se si duhet të organizohet kjo zyrë për t'iu përshtatur sa më mirë objektivave të UAMD-së, por në anën tjetër është e qartë për ne se, ashtu siç është aktualisht, ajo nuk mund të përmbushë në mënyrë të kënaqshme detyrat që i janë caktuar në *Planin Strategjik të Aktiviteteve 2021-2023*. Pra, megjithëse nuk është një dobësi, ne e shohim atë si një pengesë të mundshme në të ardhmen e afërt dhe për rrjedhojë i **rekomandojmë**

universitetit ta (ri)strukturojë këtë Qendër dhe t'i sigurojë asaj gjithçka që nevojitet për të përmbushur detyrimet e saj dhe objektivin e përgjithshëm të UAMD-së për të qenë një universitet i bazuar në kërkime. **[Kapitulli III Standardi I.5]**

- 1.6 Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore të mbikëqyrjes, UAMD-ja përgatit dhe i paraqet një raport vjetor ministrisë përgjegjëse për arsimin. Raporti konceptohet, përpilohet dhe shqyrtohet nga një grup personash të nivelit të lartë dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Raporti, i cili analizon procesin e mësimdhënies, ofron një analizë gjithëpërfshirëse të aktiviteteve të ndërmarra nga universiteti, diskutohet në të gjithë institucionin dhe rezulton të jetë një produkt gjithëpërfshirës dhe analitik. **[Kapitulli III Standardi I.6].**
- 1.7 Siç shihet në strukturën/skemën organizative të UAMD-së **[A.E12]**, universiteti ka pesë fakultete si më poshtë: Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, Fakulteti i Edukimit, Fakulteti i Studimeve Profesionale dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit. Secili prej këtyre fakulteteve ka të paktën tre departamente, gjë që është në përputhje me Statutin e UAMD-së dhe ligjin për arsimin e lartë. Këto fakultete ofrojnë programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. Megjithatë, në mënyrë të ngjashme me statutin, organika e universitetit nuk pasqyron riorganizimin e fakultetit të studimeve të integruara me praktikën në formën e departamentit. Prandaj, siç thuhet në paragrafin 1.2 më sipër, **është parësore që riorganizimi të pasqyrohet në të gjitha dokumentet universitare** dhe, kur e kërkon ligji, dokumentet e rishikuara të miratohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. **[Kapitulli III Standardi II.1].**
- 1.8 Nëpërmjet RVV-së dhe në takime të ndryshme gjatë vizitës rishikuese, UAMD-ja argumentoi se ndjek në mënyrë aktive dinamikën e biznesit vendas dhe e përdor informacionin e mbledhur për të monitoruar dhe vlerësuar kurrikulat e saj si dhe për të filluar programe të reja studimi. **[BM2 Takim me rektorin; BM10 Takim me drejtuesit e lartë të universitetit; RVV].** Fakti që universiteti ka një rritje të vazhdueshme të numrit të studentëve, ndërkohë që universitetet e tjera publike përballen me një numër në rënie, mund të shihet si një tregues që studentët e perceptojnë diplomën e UAMD-së si më të favorshme për punësim më të shpejtë dhe më të mirë. Në këtë pikë, grupit të rishikimit i bëri përshtypje shumë pozitive konkretizimi i bashkëpunimit me bizneset vendase për përmirësimin e kurrikulave, pasurimin e instrumenteve didaktike në dispozicion të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe ofrimin e rrugëve të qarta për studentët, çka së bashku shtojnë gjasat për punësim të mirë. Në mënyrë të veçantë, ekipi i rishikimit thekson bashkëpunimin midis UAMD-së dhe *Crystal Systems Group* me qendër në Qipro për studentët e IT-së si një shembull i **praktikës së mirë** në lidhje me bashkëpunimin aktiv dhe produktiv me aktorët e biznesit lokal, që njëkohësisht ndihmon në përmirësimin e mësimdhënies dhe mundëson integrimin e studentëve në tregun e punës. **[Kapitulli III Standardi III.1].**
- 1.9 Duke qenë se UAMD-ja ka një komponent të rëndësishëm praktik - një fakultet tërësisht të dedikuar për studime profesionale dhe 18 programe të studimit profesional - marrëdhënia me partnerët e jashtëm lokal të biznesit, siç u përmend më lart, është thelbësore si për praktikën mësimore, ashtu edhe për një vend afatgjatë pune për të diplomuarit. Gjatë takimeve që patëm me studentët dhe

partnerët e jashtëm të universitetit, ekipi i rishikimit arriti të vlerësojë si morinë, ashtu edhe thellësinë e një bashkëpunimi të tillë të zhvilluar ndër vite **[BM12 Takim me partnerë të jashtëm dhe alumni; BM3 Takim me një kampion studentësh të ciklit të parë; BM4 Takim me një kampion studentësh të ciklit të dytë; BM6 Takim me një kampion të stafit mësimdhënës]**. Dy vitet e fundit padyshim kanë qenë më të vështira për shkak të COVID-19 dhe, në rastin e Durrësit, edhe për shkak të tërmetit shkatërrues. Sidoqoftë, partnerët e jashtëm dhe punëdhënësit konfirmuan se studentët e UAMD-së në praktikat mësimore, si dhe ata që gjejnë punë të përhershme, kanë njohuri të mira teorike dhe janë të përgatitur për të qenë profesionistë të suksesshëm. E rëndësishme është se ata shprehën vullnetin për të zgjeruar bashkëpunimin ekzistues, veçanërisht në industrinë e hotelerisë që është vendimtare për Durrësin, pasi nevojat e tregut të punës janë të mëdha dhe gjithnjë në rritje.

Për sa i përket zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, vërejmë me kënaqësi se panairët e punës duket se janë bërë pjesë e kalendarit periodik të aktiviteteve të universitetit. Megjithatë, vumë re, gjithashtu, se universiteti nuk ka një "bankë të dhënash" të strukturuar me informacione të përditësuara për të diplomuarit e UAMD-së për të gjurmuar punësimin dhe statusin e tyre profesional. Në këtë drejtim, universiteti duhet të përdorë më mirë strukturën e programit GRADUA, si shembull i mundshëm, në lidhje me komunikimin me alumnit dhe gjurmimin periodik të tyre. Duke qenë se UAMD-ja është institucioni më i ri publik i arsimit të lartë në Shqipëri, ai duhet të 'luftojë' shumë më fort për krijimin e një imazhi të njohur në publik. Alumnit mund të kenë një rol vendimtar për ta bërë këtë dhe kjo është arsyeja pse afrimi i ish studentëve është veçanërisht i rëndësishëm dhe duhet bërë përmes metodash inovative të larmishme. Kjo do të thotë që universiteti duhet ta zgjerojë fushën e aktiviteteve për angazhimin e të diplomuarve përtej aktiviteteve tradicionale që organizojnë universitetet e tjera. Se si duhet të bëhet ky zgjerim, ia lëmë universitetit të vendosë. Ne **rekomandojmë** që zgjerimi dhe përdorimi i qasjeve inovative në komunikimin me të diplomuarit të jetë një element i rëndësishëm, ndër të tjera, edhe për t'u përgatitur për sfidat që nuk do të mungojnë të vijnë në të ardhmen.

Së fundmi, në lidhje me bashkëpunimin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, bazuar në të dhënat e ofruara nga universiteti **[RVV, f. 19-20]** UAMD-ja ka disa marrëveshje të strukturuar bashkëpunimi me një sërë partnerësh të jashtëm. Konkretisht, UAMD-ja ka marrë financim nga AKKSHI të cilin e ka përdorur për përmirësimin e infrastrukturës kërkimore dhe përmirësimin e disa laboratorëve të rëndësishëm për mësimin dhe kërkimin e aplikuar. Nga këndvështrimi rajonal, UAMD-ja është institucion partner në një projekt të zbatuar nga Shoqata e Universiteteve të Ballkanit, i cili synon të institucionalizojë një platformë për shkëmbimin e informacionit dedikuar kërkimit. Po aq e rëndësishme është se UAMD-ja është i vetmi IAL shqiptar që bashkëpunon me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC) për krijimin e një rrjeti të infrastrukturës kërkimore në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Së fundmi, dhe më e rëndësishme, që ngjall shpresë pozitive, është se UAMD-ja është i vetmi IAL në Shqipëri që drejton dy programe Erasmus+ për ndërtimin e kapaciteteve. **[Kapitulli III Standardi III.2].**

1.10 Për sa i përket bashkëpunimit me institucionet dhe partnerët e jashtëm kombëtar, grupi i rishikimit është i mendimit se UAMD-ja është i pozicionuar mirë dhe zbaton një qasje efektive, proaktive dhe mikpritëse veçanërisht ndaj institucioneve rajonale me qendër në Durrës. Nëpërmjet bashkëpunimit me Bashkinë e Durrësit, Autoritetin Portual, Durrës dhe institucione të tjera, UAMD-ja ka mundur të ofrojë praktika mësimore, në mënyrë të veçantë për programet e tij profesionale. Krahas numrit të marrëveshjeve, UAMD-ja ka hapur dyert edhe për partnerët e jashtëm duke u mundësuar atyre që në një lloj kuptimi të 'bashkëmësojnë' studentët me qëllim që t'i përgatisin të integrohen lehtësisht në tregun e punës. Siç u theksua në paragrafin 1.8 më sipër, UAMD-ja ka politika dhe praktika të mira dhe efektive që duhet të shërbejnë si shembuj për t'u zgjeruar më tej në këtë drejtim. **[Kapitulli III Standardi III.3].**

1.11 UAMD-ja zbaton një shumëllojshmëri marrëveshjesh dhe praktikash bashkëpunimi ndërkombëtar. Nisur nga shtypa e fundit e qeverisë për ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë, UAMD-ja është në fazat përfundimtare të finalizimit të një marrëveshjeje me Universitetin e Nicës, Francë për diploma të dyfishta **[BM2 Takim me rektorin]**. Për këtë qëllim, universiteti ka edhe një *Strategji* më të gjerë *Ndërkombëtarizimi 2019-2021 [AE.6]*, e cila është tregues i rëndësisë që universiteti i jep ndërkombëtarizimit. Në përgjithësi, marrëveshjet më me ndikim ndërkombëtar të bashkëpunimit janë ato që u mundësojnë stafit dhe studentëve të ndërmarrin lëvizje ndërkombëtare si Erasmus+ dhe CEEPUS. Si përmes dokumentacionit, ashtu edhe në takimet gjatë vizitës rishikuese, grupi i informimit të jashtëm u informua për rëndësinë dhe ndikimin në universitet të marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar që janë në proces zbatimi.

Megjithatë, identifikuam një kufizim në këtë fushë. Sipas UAMD-së, që nga viti 2016, 31 studentë kanë përfituar nga mobilitetet ndërkombëtare me financim të plotë [RVV fq. 21]. Edhe duke marrë parasysh tërmetin e vitit 2019 dhe pandeminë COVID-19 që pasoi, ky është një numër i ulët për një universitet të madh. Gjatë takimeve të zhvilluara në kohën e vizitës në terren, na u dhanë të dhëna inkurajuese për mobilitetet e planifikuara për vitin aktual akademik, të cilat tregojnë një rritje të dukshme **[BM7]**. Megjithatë, ekipi i vlerësimit është i mendimit se universiteti nuk po përdor sa duhet një instrument të fuqishëm - me financimin të plotë nga jashtë - si për rritjen e profilit ndërkombëtar, ashtu edhe për përgatitjen e studentëve. Për këtë qëllim, duke qenë se strategjia e ndërkombëtarizimit në fuqi përfundon në vitin 2021, ne **rekomandojmë fuqimisht** që UAMD-ja të hartojë një plan konkret veprimi, me piketa konkrete, për rritjen e numrit të studentëve që përdorin mobilitetet ndërkombëtare. **[Kapitulli III Standardi III.4].**

1.12 Në përgjithësi, grupi i rishikimit konstaton se **UAMD-ja përmbush standardet shtetërore të cilësisë për menaxhimin dhe organizimin**. UAMD-ja ka struktura dhe procedura të konsoliduara në lidhje me organizimin e procedurave akademike dhe administrative. Të gjitha dokumentet kryesore të parashikuara në ligj, që drejtojnë jetën institucionale dhe akademike, janë të disponueshme, të shkruara mirë dhe të shoqëruara me mekanizmat përkatës zbatues. Për më tepër, janë ngritur dhe funksionojnë të gjitha zyrat e nevojshme për të menaxhuar procedurat akademike dhe administrative të universitetit, ndonëse disa prej tyre nuk kanë staf të përshtatshëm. Ekzistojnë, gjithashtu, disa çështje, që përmenden më lart, në lidhje me shkallën e mobilitetit së studentëve dhe qasjen ndaj ish studentëve. Në

përgjithësi, siç tregohet më poshtë në përmbledhjen e gjetjeve, ekipi i rishikimit identifikon 2 praktika të mira, asnjë dobësi, 4 rekomandime dhe 1 konfirmim që duhet të shihen në tërësi, si elementë përbërës të një tabloje më të madhe, ku këta elementë duhet të integrohen me njëri-tjetrin gjithnjë e më shumë për të bërë të mundur që një universitet modern me ambicie dhe mundësi si UAMD-ja të përmirësojë vazhdimisht veten dhe të zgjerojë gamën e mundësive që ofron për studentët.

Gjetjet

Praktika e mirë

Ekipi i rishikimit identifikoi elementët e mëposhtëm të praktikës së mirë:

- Plani Strategjik i UAMD-së 2020 – 2022 shoqërohet me dokumentin e Planifikimit të Aktiviteteve Strategjike 2021-2023, i cili përvijon piketat, arritjet, afatet dhe njësinë(të) përgjegjëse. Kjo praktikë duhet të zgjerohet për të gjitha dokumentet e tjera strategjike pasi mundëson ndjekjen, zbatimin dhe llogaridhënien **[Kapitulli III Standardi I.5]**.
- Bashkëpunimi i strukturuar i UAMD-së me *Crystal Systems Group* me qendër në Qipro është një praktikë e mirë që mundëson përmirësimin e mësimdhënies, pasurimin e instrumenteve didaktike dhe integrimin e pandërprerë të studentëve në tregun e punës **[Kapitulli III Standardi III.1]**.

Dobësitë

Ekipi i rishikimit identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Ekipi i rishikimit nuk identifikoi dobësi.

Rekomandime

Ekipi i rishikimit identifikoi rekomandimet e mëposhtme:

- Dokumentet e UAMD-së – veçanërisht statuti dhe organigrama – duhet të pasqyrojnë riorganizimin e fundit institucional të tij. Në lidhje me këtë, UAMD-ja, brenda vitit akademik 2021 – 2022, duhet të marrë miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin për dokumentet e rishikuara që pasqyrojnë këtë riorganizim, në rastet kur kjo parashikohet në ligj. **[Kapitulli III Standardi I.1; Kapitulli III Standardi I.4]**.
- UAMD-ja duhet të hartojë dhe zbatojë një plan veprimi të strukturuar - me piketa dhe afate konkrete - për rritjen e numrit të studentëve që përfitojnë nga mobilitetet ndërkombëtare **[Kapitulli I Standardi III.8]**.
- Qendra për Kërkim dhe Ekselencë e UAMD-së duhet të bëhet 'e përshtatshme për qëllimin' duke u pajisur me personel të përshtatshëm - si në numër ashtu edhe në raportin midis stafit administrativ dhe atij akademik - për të garantuar zbatimin e detyrave të ngarkuara nga dokumenti i Planifikimit të Aktiviteteve Strategjike 2021-2023 dhe më tej. **[Kapitulli III Standardi I.5]**
- UAMD-ja duhet të ngrejë një bazë të dhënash të strukturuar dhe të përditësuar të alumnit, në të cilën të gjurmohet zhvillimin e tyre profesional dhe statusin e punësimit. Për më tepër, UAMD-ja duhet të institucionalizojë takime periodike dhe të gjejë qasje

inovative për komunikimin me rrjetin alumni të ndryshme nga ato që ka ndjekur deri tani. **[Kapitulli I Standardi III.1]**

Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra

Ekipi i rishikimit konfirmon veprimet e mëposhtme që janë në proces:

- UAMD-ja është në fazat përfundimtare të nënshkrimit të një marrëveshjeje me Universitetin e Nicës, Francë, për ofrimin e diplomave të dyfishta **[Kapitulli III Standardi III.4]**.

Gjykim

Standardet për organizatën dhe drejtimin e saj janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 UAMD-ja është një institucion i arsimit të lartë, i cili funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar për arsimim e lartë, ligjin dhe aktet nënligjore. Struktura organizative është në përputhje me Ligjin 80/2015 për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Statuti i UAMD-së dhe rregulloret përkatëse janë në përputhje me këtë ligj. Organigrama e UAMD-së është e publikuar në faqen e internetit **[A.E7]**. Në kuadër të strukturës së përgjithshme organizative të miratuar për UAMD-në, rolet e personelit akademik dhe administrativ paraqiten në detaje **[Vendim Bordi, 31.05.2018]**. Ekipi i rishikimit konstatoi se punësimi në njësitë akademike bëhet mbi bazën e analizës së nevojave specifike për fakultetin, departamentin, programin e studimit dhe kurrikulën si dhe sipas llojit të pozicionit me kohë të plotë apo të pjesshme. Njësia akademike është e pavarur në miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e personelit, të cilat miratohen nga rektori. Gjatë vizitës rishikuese, stafi dhe drejtuesi i departamenteve ishin plotësisht në dijeni të procedurës për emërimet e stafit akademik. Vendet e lira të punës janë të hapura për publikun dhe shpallen në faqen në internet të universitetit në përputhje me rregulloren e punësimit **[A.E2.1]**. Për çdo pozicion të shpallur bëhet një përshkrim i qartë të pozicionit të punës, kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët, dokumentet e kërkuara dhe afatin e fundit për aplikim. UAMD-ja zbaton të njëjtat procedura dhe rregullore edhe për stafin me kohë të pjesshme. Proceset e punësimit për personelin mësimor, shkencor dhe administrativ ndjekin të njëjtin proces që përcaktohet në Statut dhe Rregullore, dhe këto të fundit mbajnë parasysh ligjin përkatës. Sa i përket vlerësimit të aplikantëve, ka dy faza. Në fillim bëhet vlerësimi i dosjes dhe më pas intervistat me aplikantët. Shefi i departamentit krijon një komision vlerësimi *ad hoc* me 5 anëtarë (3 prej të cilëve nga departamenti) për të shqyrtuar aplikimet. Vlerësimi kryhet në bazë të meritave individuale dhe kontrata e punës nënshkruhet nga Rektori **[A.E1]**. Komisioni i vlerësimit i jep përparësi personelit akademik të kualifikuar në universitete të njohura ndërkombëtare në bazë të pikëve, dhe harton një listë me rend zbritës. Më pas, drejtuesi i departamentit i propozon rektorit listën e aplikantëve me pikët përkatëse në bazë të vendimit të komisionit vlerësues dhe më pas rektori merr vendimin përfundimtar. Ekipi i rishikimit rekomandon që t'i kushtohet më shumë vëmendje tërheqjes së stafit të kualifikuar, veçanërisht atyre që kanë përfunduar studimet në institucione me reputacion jashtë vendit. Megjithëse tërheqja e stafit akademik me cilësi të lartë nuk ndikohet vetëm nga politikat e UAMD-së, ky i fundit duhet të bëjë më shumë përpjekje për të futur skema të reja nxitëse në të ardhmen, si pjesë e objektivave të ndërkombëtarizimit **[Kapitulli III, Standardi IV.1]**.
- 2.2. UAMD-ja është e angazhuar për zbatimin e politikave integruese lidhur me stafin akademik dhe administrativ siç parashikohet në Statutin dhe Planin Strategjik të Zhvillimit **[A.E4]** si dhe Strategjinë e Ndërkombëtarizimit 2019-2021 **[A.E6]** të Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Projekte **[A. E10]**. Edhe pse në raportin e vetëvlerësimit thuhet se misioni i këtij departamenti është të rrisë shkallën e ndërkombëtarizimit përmes projekteve të bashkëpunimit shkencor, ekipi vlerësues vuri re se bashkëpunimi ndërkombëtar kufizohet kryesisht në mobilitetin e stafit, kurse dokumentet për bashkëpunimin në projekte shkencore janë të pakta. Prandaj, grupi i rishikimit rekomandon që UAMD-ja t'u japë përparësi projekteve shkencore, dhe jo vetëm mobilitetit të stafit, seminareve dhe konferencave. Personeli akademik konfirmoi pikëpamjen e shprehur në raportin e vetëvlerësimit se ata janë të angazhuar në një

sërë aktivitetesh, të tilla si seminare, aktivitete në terren dhe organizime të ndryshme shoqërore përveç mësimdhënies, përfshirë konferencën e organizuar nga UAMD-ja çdo vit **[A.E39]**. Universiteti mbështet integrimin e stafit akademik dhe administrativ në jetën shoqërore dhe i inkurajon ata të jenë pjesë e aktiviteteve të ndryshme si ditët kushtuar ish-studentëve **[A.E85, AE.89]**. Të gjithë punonjësit e UAMD-së kanë sigurim shëndetësor pasi paguajnë 'Kontributin e detyrueshëm për sigurimin shëndetësor'; ky kontribut paguhet në përputhje me legjislacionin përkatës. **[Kapitulli III, Standardi IV.2]**.

- 2.3. UAMD-ja është e angazhuar për zhvillimin dhe vlerësimin e stafit në përputhje me parashikimet e dokumenteve dhe rregulloreve të saj strategjike. Universiteti ndjek një politikë të trajnimit të vazhdueshëm dhe zhvillon vlerësimin periodik të stafit me synim nxitjen e zhvillimit profesional **[E.A52]**. Për këtë qëllim, UAMD-ja ka krijuar një tabelë për vlerësimin e punës kërkimore të stafit **[A.E80, A.E81, RVV f. 26]**. Manualët e trajnimit për mësimet online janë të rëndësishme dhe UAMD-ja duhet të vazhdojë të zhvillojë kapacitetet e stafit për metodat e mësimdhënies online. Siç theksohet në RVV, por edhe gjatë vizitës rishikuese, universiteti duhet të caktojë më shumë buxhet për aktivitetet kërkimore dhe zhvillimin profesional të stafit. Buxheti për punë kërkimore përfaqëson vetëm 3 % të buxhetit total. Ekipi i vlerësimit evidentoi se qendra e trajnimit nuk zhvillon aktivitete domethënëse trajnuese, për rrjedhojë rekomandon që të dedikohet më shumë buxhet dhe të bëhet një plan për zhvillimin e stafit. Në veçanti, ka nevojë për trajnime të stafit të ri lidhur me teknikat e mësimdhënies. Gjithashtu, Qendra Kërkimore në UAMD nuk ka objektiva strategjike të harmonizuara me instrumentet për zbatimin e këtyre objektivave strategjike. Mbështetja financiare e stafit për pagesën e tarifave të konferencave dhe revistave është një praktikë e mirë dhe inkurajuese, por nuk mjafton për zhvillimin e mëtejshëm të stafit për të ndërmarrë kërkime. Tabela e vlerësimit tregon se ka nevojë për përmirësimin e cilësisë së botimeve **[Kapitulli III, Standardi IV.3]**.
- 2.4. UAMD-ja ndjek politika për integrimin social dhe profesional nëpërmjet një game të gjerë aktivitetesh për të inkurajuar dialogun social ndërmjet stafit, studentëve dhe komunitetit të gjerë **[RVV f. 26; A.E 84; A.E85; A.E 59]**. Shembuj të mirë përfshijnë ditët e hapura për studentët dhe Javën e Orientimit në Karrierë. Konferencat e organizuara nga UAMD-ja ofrojnë mundësi për stafin në tërësi si dhe për studentët për t'u lidhur dhe aktivizuar me institucionet lokale. Aktivitete të tjera si promovimi i librave, trajnimi për aftësitë e buta, ceremonitë e mirënjohjes për figura të rëndësishme, aktivitetet sportive, Çmimi i Karrierës, etj., janë një tjetër praktikë e mirë që nxit studentët për rezultate të larta dhe për të qëndruar gjithmonë në lidhje më pas si alumni **[Kapitulli III, Standardi IV .4]**.
- 2.5. UAMD-ja zbaton Ligjin e Punësimit të Republikës së Shqipërisë (Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995) dhe aktet e tij nënligjore **[A.E 86]**. Për të siguruar efikasitetin e burimeve njerëzore, kontratat specifikojnë rolet dhe përgjegjësitë e secilit personel akademik të caktuar në departamentet përkatëse. Çdo vit UAMD-ja, në marrëveshje me stafin akademik, ofron një plan me shkrim për ngarkesën e punës **[A.E87]**. Ekipi i rishikimit evidentoi se duhet të forcohet kontrolli i cilësisë së mësimdhënies **[Kapitulli III, Standardi II.2]**.

- 2.6. UAMD-ja e ushtron autonominë e vet financiare në përputhje me rregullat dhe standardet e programimit buxhetor dhe menaxhimit të financave publike në Shqipëri bazuar në ligjin nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin në Institucionet e Arsimit të Lartë **[RVV f. 27]**. Ndarja e buxhetit planifikohet dhe propozohet nga Senati dhe miratohet nga Bordi Administrativ i UAMD-së. Në aspektin teknik, Bordi i Administrimit, miraton buxhetin, i cili hartohet nga Administratori. Stafi konfirmoi se çështjet buxhetore diskutohen në të gjitha bordet dhe komisionet përkatëse në departamente, fakultete dhe në Senatin Akademik **[A.E42, A.E44]**. UAMD-ja ka një sistem të centralizuar të menaxhimit financiar dhe njësitë akademike nuk kanë autonomi të plotë financiare. Megjithatë, transparenca sigurohet nëpërmjet diskutimit të çështjeve financiare në Senatin Akademik, i cili përfshin përfaqësues të stafit dhe studentëve. Procesi i hartimit të buxhetit dhe sistemi i menaxhimit administrativ-financiar është i strukturuar mirë, efikas dhe i njohur për stafin **[RVV f. 28]**. Të gjitha nevojat dhe kërkesat e UAMD-së grupohen dhe prokurohen nga mekanizmi qendror i menaxhimit financiar. Pavarësisht sistemit të shëndoshë të menaxhimit, grupi i rishikimit evidentoi si kërcënim për shëndetin financiar të institucionit pamundësinë e UAMD-së për të gjeneruar të ardhura nga të burime të tjera dytësore. Kështu, ne rekomandojmë që strategjia financiare të fokusohet në gjetjen e burimeve të tjera financiare. **[Kapitulli III. Standardi VI.1]**
- 2.7. Të ardhurat dhe ndarja e buxhetit janë të centralizuara. Tarifat e studentëve janë burimi kryesor i gjenerimit të të ardhurave. UAMD-ja duhet të ketë burime më të larmishme për të ardhurat në të ardhmen **[RVV]. [Kapitulli 3 Standardi VI.2]**.
- 2.8. UAMD-ja ka hartuar dhe zbaton politikën e kontrollit buxhetor dhe financiar. Bordi i Administrimit ka krijuar një Njësi të Auditimit të Brendshëm, e cila i raporton drejtpërdrejt bordit dhe ka pavarësi të plotë në ekzekutimin e detyrave të saj **[RVV f. 28; A.E46]**. Auditimi i brendshëm nuk ka konstatuar asnjë gjetje në raportin e auditimit **[E.A47]** çka flet për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar. **[Kapitulli III, Standardi VI.3]**
- 2.9. Në UAMD ka një mekanizëm informimi dhe komunikimi, i cili është në varësinë e Departamentit të Administratës dhe Shërbimeve Akademike, Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. UAMD-ja ka hartuar strategjinë e komunikimit dhe ka ndërtuar segmentet kryesore të mjeteve të komunikimit **[A,E12, A.E17]**. Po ashtu, ka një format të miratuar për raportimin, gjë që e bën komunikimin më efikas **[Kapitulli III Standardi VII.1]**
- 2.10. UAMD-ja ka në përdorim një sistem për mësimin online bazuar në paketën *Google Meet and Moodle*. Edhe pas COVID-19, stafi vazhdon t'i përdor ato mjete sepse i gjen të dobishme për ndërveprimin dhe diskutimin me studentët. Faqja e internetit e UAMD-së është mjeti kryesor i komunikimit dhe informacionit për shpërndarjen e informacionit në nivel vertikal dhe horizontal. **[<https://www.uamd.edu.al>]**. Faqja zyrtare e internetit ofron një tablo të plotë, informacion strategjik dhe njoftime publike në lidhje me nevojat akademike të njësive kryesore dhe atyre bazë, mundësitë e karrierës, historitë e suksesit, aktivitetet, etj. Faqja, gjithashtu, u ofron studentëve informacion në lidhje me studimet, aktivitetet sociale ose rrjetet e ish-studentëve, bursa dhe mundësi pune. Megjithatë, ekipi i rishikimit vë në dukje se UAMD-ja duhet të bëjë përpjekje serioze për të përditësuar versionin anglisht të faqes së internetit, veçanërisht si pjesë e përpjekjeve për ndërkombëtarizimin e tij. UAMD-ja ka gjithashtu një prani shumë të

mirë në Facebook dhe Instagram (12 mijë anëtarë në Facebook). Komunikimi i stafit bazohet kryesisht në komunikimet me email dhe mjetet e komunikimit me shkrim, përfshirë emaillet personale. Për qëllime mësimore, platforma e-learning përdoret nga studentët për të gjetur literaturë dhe informacion për zhvillimin profesional të stafit akademik. E-biblioteka është e disponueshme, por numri i përdoruesve mbetet i ulët, në më pak se 1000. Ekipi i rishikimit rekomandon inkurajimin e studentëve dhe stafit akademik që të përdorin më shumë burime elektronike, veçanërisht duke e bërë të detyrueshme për studentët që në detyrat e caktuara të përdorin burimet në internet. **[Kapitulli III, Standardi VII.2]**

- 2.11. Universiteti ka të gjitha dokumentet e nevojshme për asetet në pronësi të tij **[A.E9]**. UAMD-ja monitoron nga afër përdorimin e burimeve/aseteve sipas kërkesave të mësimdhënies dhe kërkimit. UAMD-ja i zhvillon aktivitetet mësimore dhe kërkimore në tre ndërtesa **[RVV f. 29-30]**. Grupi vlerësues evidentoi se UAMD-ja ka infrastrukturë të përshtatshme, me të gjitha ambientet e nevojshme për garantimin e një procesi normal të mësimdhënies. Sipërfaqja e objekteve është në raport me numrin e studentëve. Ekipi i rishikimit konfirmoi se cilësia e akomodimit, si dhe lehtësitë dhe aksesin për individët me aftësi të kufizuara, në përgjithësi, plotësojnë kërkesat ligjore. Ekipi i rishikimit ka vizituar të gjitha mjediset e kampusit si dhe laboratorët e klasat **[Kapitulli III Standardi VII.3]**.
- 2.12. UAMD-ja ka një politikë të fortë akademike dhe të trashëgimisë kulturore dhe arkivon botimet e stafit akademik, disertacionet, si dhe punimet e projekteve të realizuara nga studentët, të cilat ruhen në Bibliotekë. Arkivi është i disponueshëm për studiuesit e interesuar brenda dhe jashtë universitetit. UAMD-ja ka revistën e vet shkencore (me akses të hapur) dhe ofron botim falas për stafin e UAMD-së. Universiteti i kushton vëmendje të veçantë digjitalizimit të bazave të të dhënave dhe deri tani përdor dy baza të digjitalizuara të të dhënave: Koha dhe COBISS. Ekipi i rishikimit evidentoi se ekziston një sistem efektiv i koordinuar i menaxhimit për të siguruar kujdesin dhe ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe informacionit, duke përfshirë të dhënat e studentëve të mbajtura nga sekretaritet mësimore. Studentët dhe stafi i UAMD-së mund të përdorin një burim tjetër online si bibliotekë përmes U-Library (EBSCO) dhe jstor.org **[A.E91, A.E92] [RVV f. 29] [Kapitulli III Standardi VII.4]**
- 2.13. Universiteti i menaxhon asetet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 dhe me Statutin e tij **[A.E1]**. Bordi Administrativ ka kompetencë të bëjë propozime për shfrytëzimin e asetëve dhe Ministria e Arsimit është përgjegjëse për miratimin. Këto procedura dhe çështje të tjera i janë konfirmuar ekipit të vlerësimit në takimin me anëtarët e bordit. **[Kapitulli III Standardi VII.5]**
- 2.14. Infrastruktura e UAMD-së është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për veprimtari mësimore, kërkimore, sociale dhe kulturore. Në veçanti, hapësirat për studentët janë të përcaktuara dhe, me ndërtesat e reja, hapësirat në dispozicion për aktivitete sociale do të jenë të mjaftueshme. Për të përmbushur pritshmëritë dhe nevojat e studentëve dhe stafit, UAMD-ja organizon periodikisht një anketë me studentët dhe stafin. Rezultatet e anketës paraqiten në një raport i cili i dërgohet Komisionit për Sigurimin e Cilësisë **[A.E93]**. Nga raporti i anketës rezultoi se 41,4 % e studentëve kanë deklaruar se nuk janë të kënaqur me mjetet dhe pajisjet në klasa. Ekipi i rishikimit sugjeron që duhen bërë përmirësime të tjera për të kënaqur studentët **[Kapitulli III Standardi VII.6]**.

- 2.15. Institucioni ofron logjistikë dhe infrastrukturë adekuate për stafin akademik, krahas mbështetjes profesionale që marrin nga personeli teknik dhe mbështetës. Ata kanë hapësirë të mjaftueshme për aktivitete mësimore dhe kërkimore, përfshirë amfiteatro, laboratorë, klasa, laboratorë kompjuterësh, salla konferencash, biblioteka etj. Gjithashtu, brenda kampusit të UAMD-së ka sipërfaqe të mëdha me gjelbërim.
[Kapitulli III Standardi V.1]
- 2.16. UAMD-ja disponon dokumentacionin e plotë, si në letër ashtu edhe në formë elektronike, të të gjitha aktiviteteve akademike. Universiteti ka një sektor për arkivimin e dokumenteve sipas kërkesave ligjore **[A.E13]**. Çdo dosje është e sistemuar dhe e depozituar në mënyrë adekuate. Për qëllime të prodhimit të statistikave, departamenti i Administratës dhe Shërbimeve Akademike mbledh, përpunon dhe ruan të dhënat për studentët aktualë, të huajt, të diplomuarit, por edhe për stafin akademik dhe teknik. Të gjitha të dhënat i raportohen Ministrisë së Arsimit në përputhje me kërkesat ligjore.
[Kapitulli III Standardi V.2].

Gjetjet

Praktika e mirë

Ekipi i rishikimit identifikoi tiparet e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Ekipi i rishikimit nuk identifikoi ndonjë praktikë të mirë.

Dobësitë

Ekipi i rishikimit gjeti dobësitë e mëposhtme:

- Ekipi i rishikimit nuk identifikoi ndonjë dobësi.

Rekomandime

Ekipi i rishikimit bëri Rekomandimet e mëposhtme:

- Vlerësimi i performancës së stafit të UAMD-së duhet të përfshijë më shumë kriteret për botimin në revista me faktor impakti dhe duhet të shoqërohet me buxhetin për zhvillimin e stafit me fokus në financimin e projekteve kërkimore. **[Kapitulli III Standardi IV.3]**
- Strategjia financiare e UAMD-së duhet të fokusohet në diversifikimin e burimeve financiare. Në këtë drejtim, ekzistojnë mundësi për komercializimin e disa prej aktiviteteve kërkimore ose rritjen e financimit nga projektet/donatorët dhe/ose kompanitë private. **[Kapitulli III, Standardi VI.1]**
- UAMD-ja duhet të inkurajojë studentët dhe stafin akademik që të përdorin më shumë burime elektronike, veçanërisht duke e bërë të detyrueshme që studentët të përdorin këto burime në përgatitjen e detyrave që iu caktohen. **[Kapitulli III, Standardi VII.2]**
- UAMD-ja duhet të përditësojë versionin anglisht të faqes në internet veçanërisht gjatë këtij momenti të rëndësishëm për ndërkombëtarizimin e tij. **[Kapitulli III, Standardi VII.2]**

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Ekipi i rishikimit konfirmon veprimin e mëposhtëm të ndërmarrë:

- Hapat e UAMD-së për t'u përballur me COVID-19 janë për t'u përshëndetur veçanërisht përdorimi i *Google meet and muddle* për të lehtësuar mësimdhënien dhe të mësuarit në internet. UAMD-ja duhet të vazhdojë t'i përdorë këto mjete online për të plotësuar mësimin edhe në periudhën pas Covid-19. **[Kapitulli III, Standardi VII.2]**

Gjykim

Standardet për burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Programet e studimit në UAMD janë në përputhje me misionin dhe infrastrukturën e universitetit. Megjithatë, aktivitetet kërkimore dhe performanca kërkimore nuk janë plotësisht në përputhje me misionin e UAMD-së ku deklarohet se universiteti bazohet në kërkime **[A.E1]**. Programet e studimit janë në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe disa profile janë të konceptuara mirë për të mbështetur zhvillimin ekonomik vendor. Në përafrimin e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës, shoqata dhe rrjeti i Alumnit të UAMD-së ka luajtur një rol të rëndësishëm. Si rezultat, programet e studimit të UAMD-së janë themeluar në përputhje me misionin dhe objektivin e tij për përgatitjen e specialistëve të rinj për nevojat e tregut të punës për mësues, ekonomistë, juristë dhe politologë, si dhe për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. **[Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.2 Krahas misionit kryesor për ofrimin e programeve profesionale të studimit për ciklin e parë, UAMD-ja ofron edhe programe studimi (cikli i dytë), të cilat konsiderohen si edukim në vazhdim **[A.E58]** **[RVV, f. 33]**. Për sa i përket të mësuarit gjatë gjithë jetës (Life Long Learning), janë hartuar module trajnimi për të përballuar nevojat në zhvillim të tregut të punës. Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën, i cili ungrit në vitin 2008 në kuadrin e një projekti pilot të mbështetur nga qeveria gjermane, është shembull shumë i mirë i akademisë profesionale që përgatit profesionistë të aftë për nevojat e tregut të punës **[A.E145; RVV f 6]**. UAMD-ja ka 15 programe studimi profesionale (2 vite studim). Ai ofron programe studimi për studentët e punësuar që ata të studiojnë dhe punojnë njëkohësisht, ku mësimi zakonisht zhvillohet pasditeve. Gjithashtu, UAMD-ja ofron programe trajnimi për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe ofron trajnime jashtëshkollore në bashkëpunim me bizneset private apo partnerë të tjerë ndërkombëtarë, si për studentët aktualë ashtu edhe për ish studentët. **[Kapitulli I Standardi I.2]**
- 3.3 Bazuar në strategjinë **[A.E4]** dhe statutin **[A.E1]**, njësitë kryesore akademike të UAMD-së organizojnë dhe përditësojnë periodikisht programet e tyre të studimit. Përditësimi i programeve të studimit u mundëson njërive akademike të përshtaten me nevojat e tregut të punës. Kjo është në përputhje me planin strategjik të UAMD-së ku thuhet se institucioni i kushton vëmendje të veçantë përmirësimit të programeve të studimit dhe zhvillimit të mëtejshëm shkencor të stafit akademik për të identifikuar saktë dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate nevojave të tregut **[A.E4]**. Bashkëpunimi i rrënjosur tashmë i UAMD-së me institucionet publike vendase dhe kompanitë private ofron mundësi për praktika të suksesshme dhe punësim pas diplomimit, gjë që u theksua edhe në takimin me një grup mësuesish dhe përfaqësues të partnerëve të jashtëm dhe ish-studentëve **[A.E59, A.E85]**. Rasti i kompanisë *Crystal* është shembull i mirë i këtij bashkëpunimi, ku kompania ka ofruar mbështetje me pajisje dhe mjete për laboratorët e UAMD-së. **[Kapitulli I Standardi I.3]**
- 3.4 Të gjitha programet e studimit hartohen nga njësitë akademike duke respektuar kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar për t'u shërbyer nevojave vendore dhe ndërkombëtare të tregut të punës **[A.E8]**. Pesë fakultete në UAMD ofrojnë 15 programe profesionale (2-vjeçare), 35 programe studimi në ciklin e parë dhe 42 programe në ciklin e dytë. Shembuj të mirë të hartimit të programeve të studimit bazuar në nevojën e tregut të punës janë programi i ngritur me kërkesë të partnerëve të biznesit (Programi për Sistemin ERP), apo programi i krijuar si rezultat i programit Erasmus+ (Multimedia dhe Media Digjitale) **[RVV f. 34]**. Ekipi i rishikimit rekomandon

çarjen më tej të këtyre praktikave të mira të bashkëpunimit me sektorin privat dhe partnerët ndërkombëtarë **[Kapitulli I Standardi I.4]**

- 3.5 UAMD-ja ofron programe studimi në përputhje me kapacitetin e tij institucional. Ngarkesa mësimore e një pedagogu me kohë të plotë në UAMD është përmirësuar për shkak të një rritjeje prej 25% të stafit akademik me kohë të plotë. Edhe kapaciteti fizik është rritur me 70%, veçanërisht pas ndërtimit të auditoreve të reja me një kapacitet shtesë prej 2500 vendesh për studentët. Bazuar në kapacitetin institucional, UAMD-ja planifikon numrin e studentëve për çdo vit akademik dhe për çdo program studimi. Planet për numrin e regjistrimeve propozohen nga njësitë akademike dhe miratohen nga Senati. **[A.E2]. [Kapitulli I Standardi I.5]**
- 3.6 Kurrikulat e programeve të studimit për të gjitha njësitë akademike janë të disponueshme në faqen e internetit të universitetit <https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/programet-bachelor/> ndërsa programet specifike të studimit dhe kurrikulat përkatëse gjenden në faqen e internetit të departamentit përkatës që është përgjegjës për ofrimin e atij programi studimi <https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-biznesit/departamenti-i-shkencave-ekonomike/shkenca-ekonomike/> **[A.E2]**. Objektivat e programeve të studimit përputhen me objektivat e përgjithshme të UAMD-së. Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit shpjegohen mirë dhe janë lehtësisht të aksesueshme nga studentët e interesuar. Kriteret e pranimit të studentëve janë në përputhje me ligjet dhe kuotat e nxjerra në nivel kombëtar, të miratuara nga senati dhe të publikuara në faqen e UAMD-së. Syllabuset e lëndëve për secilin program studimi nuk ishin vendosur në internet për t'i lejuar stafit, studentëve dhe studentëve të ardhshëm të njihen lehtësisht me këtë informacion dhe ekipi i rishikimit rekomandon që kjo të bëhet. **[Kapitulli I Standardi I.6]**
- 3.7 UAMD-ja ofron programe studimi në tre cikle radhazi sipas niveleve 6, 7 dhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. UAMD-ja ofron edhe studime profesionale 2-vjeçare. Të gjitha programet e studimit kanë përqindje të caktuar të lëndëve bazë për t'i pajisur studentët me njohuri të përgjithshme dhe aftësi metodologjike **[AE97]**. Studentët, në përgjithësi, mendojnë se programet aktuale të studimit dhe organizimi i njësive akademike i pajisin ata me kompetenca të përgjithshme dhe specifike si dhe formim adekuat, duke ofruar njëkohësisht mundësinë për të zgjeruar fushat e studimeve përkatëse në masë dhe thellësi më të madhe, tipikisht përmes lëndëve me zgjedhje **[RVV f. 34-35]**. Gjatë takimeve të zhvilluara, u vu re se edhe stafi administrativ dhe Shoqata Alumni janë aktivë në përpjekjet për të ndihmuar studentët e sapodiplomuar të vendosin kontakte më të mira për mundësi punësimi falë edhe partnerëve të jashtëm të UAMD-së **[A.E59]**. Kalendari i aktiviteteve me ish studentët (alumni) është i gjerë dhe një pikë e fortë e UAMD-së **[Kapitulli I Standardi I.7]**
- 3.8 UAMD-ja ka përcaktuar ditët e hapura dhe organizon vizita informuese dhe fushata të rregullta me nxënës të shkollave të mesme lidhur me ofertën dhe organizimin e studimeve në këtë universitet gjatë "ditëve të informimit të studentëve". Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni lehtëson mbarëvajtjen e studentëve në vitin e parë të studimeve **[A.E119]**. Kurrikula është konceptuar për të ndihmuar studentët të njihen me programin universitar dhe të marrin fillimisht njohuritë bazë. Lëndët themelore përfshijnë përgatitjen metodologjike, njohuritë e përgjithshme dhe kurset plotësuese për gjuhën angleze dhe aftësitë TIK, përfshirë kurset profesionale përkatëse nëpër departamente. Përveç kësaj, për të ndihmuar studentët të integrohen në mjedisin mësimor, UAMD-ja cakton një mentor për çdo student të vitit të parë **[A.E98]**. Mentorët

janë pikë referimi për trajtimin e çdo shqetësimi të studentëve. **[Kapitulli I Standardi I.8]**

- 3.9 Programet e studimit të ciklit të dytë hartohen nga njësitë akademike (departamentet) mbi bazën e njohurive të personelit akademik, punës së tyre kërkimore, ekspertizës së mbledhur dhe përmes sugjerimeve të nxjerra nga vlerësimi i studentëve dhe opinionet e punëdhënësve, përfshirë sugjerimet dhe rekomandimet e ish studentëve (alumni) **[A.E23, A.E105, A.E61]**. UAMD-ja bashkëpunon gjerësisht me partnerë të jashtëm: 31 institucione publike, organizata dhe biznese, për të marrë në mënyrë sa më efektive komentet dhe sugjerimet e tyre si dhe për të vendosur studentët gjatë periudhës së praktikës. Bashkëpunimi me biznesin dhe donatorët ndërkombëtarë evidentohet në dy programe studimi **[shih Kapitullin I Standardi I.4]**. **[Kapitulli I Standardi I.9]**.
- 3.10 Statuti i UAMD-së parashikon organizimin e studimeve në tre cikle radhazi, referuar niveleve 6, 7 dhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve **[AE1]**. Strategjia e ndërkombëtarizimit të UAMD-së thotë: “Bashkëpunimi ndërkombëtar është një prioritet strategjik i UAMD-së. Ai kërkon të jetë një faktor i rëndësishëm në arritjen e standardeve ndërkombëtare të arsimit të lartë.” Procesi i Bolonjës ofron mundësi për lëvizshmëri më të madhe si të studentëve ashtu edhe të stafit. Të gjitha programet e ciklit të parë, pra programet 3-vjeçare të nivelit Bachelor, organizohen në kurse me 180 ECTS dhe u akordojnë studentëve të drejtën për të vazhduar studimet Master, qoftë shkencor apo profesional, në ciklin e dytë. Bazuar në strategjinë e UAMD-së, prioritet është bashkëpunimi dhe lëvizshmëria ndërkombëtare, si dhe lëvizshmëria e pedagogëve dhe studentëve në programe të ndryshme **[A.E6]**. Ekipi i rishikimit vuri në dukje numrin e ulët të mobilitetit të studentëve (që nga viti 2016, vetëm 31 ishin pjesë e një programi shkëmbimi). Pavarësisht se është deklaruar shprehimisht në strategjinë e ndërkombëtarizimit, lëvizshmëria e studentëve mbetet shqetësim për UAMD-në, rrjedhimisht ekipi i rishikimit rekomandon mbështetjen e studentëve për të aplikuar në programet e mobilitetit si dhe organizimin e kurseve shtesë në gjuhë të huaja për të lehtësuar këtë proces. **[Kapitulli I Standardi I.10]**
- 3.11 Programet e studimit në UAMD kombinojnë aspektet teorike dhe zbatimin praktik të njohurive. Mësimi i bazuar në praktikë lehtësohet nëpërmjet laboratorëve, praktikave, vizitave në terren etj. Në varësi të programit të studimit, mjetet konkrete përfshijnë si instrumentet për punë praktike, ashtu edhe punën në laboratorë **[RVV, f. 36]**. Praktika është e përfshirë në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë **[A.E40, AE48]**, dhe UAMD-ja përpiqet të përputhë sa më mirë programin e studimit me institucionin e praktikës. Ekipi i vlerësimit pati mundësinë të verifikojë ekzistencën e pajisjeve dhe mjeteve të duhura për të mësuarit e bazuar në praktikë, veçanërisht në programet profesionale dhe praktike të studimit. Në përpjekje për të krijuar kushtet e përshtatshme për mësimin e bazuar në praktikë, UAMD-ja ka investuar më shumë se 600,000 Euro në pajisje laboratorike **[A.E99]**. UAMD-ja aplikon mësimin e integruar me orë pune praktike në çdo kurs duke u kërkuar studentëve të punojnë në projekte të caktuara, me një peshë prej 10% në notën përfundimtare. Disa fakultete herë pas here organizojnë workshope me studentët në formën e aktiviteteve jashtëshkollore. **[Kapitulli I Standardi I.11]**.
- 3.12 Të gjitha departamentet në UAMD i kushtojnë vëmendje të veçantë përshtatjes së programeve të studimit me nevojat e tregut të punës. Shembujt më të mirë të një bashkëpunimi të tillë janë dy programe studimi që zhvillohen në bazë të bashkëpunimit me përfaqësues të biznesit dhe donatorë ndërkombëtarë. Këta dy shembuj dhe qasja

që ato ndjekin, duhet të përvetësohen edhe nga departamentet e tjera në mënyrë që të mund të angazhohen sa më aktivisht komunitetin e biznesit dhe palët e tjera të interesuara për të kontribuar në zhvillimin e kurrikulave të reja. Në përafrimin e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës, shoqata Alumni dhe rrjeti i UAMD-së kanë luajtur një rol të rëndësishëm, krahas kërkimeve të kryera nga universiteti për tregun e punës. **[A.E61]. [Kapitulli I Standardi I.12].**

Gjetjet

Praktika e mirë

Ekipi i rishikimit identifikoi praktikën e mirë të mëposhtme:

- Hartimi i strukturuar i programeve të studimit bazuar në nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet ndërkombëtare, nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët e biznesit dhe donatorët ndërkombëtarë, është një praktikë e mirë që duhet zgjeruar dhe institucionalizuar më tej. **[Kapitulli I Standardi I.4]**

Dobësitë

- Ekipi i rishikimit nuk identifikoi ndonjë dobësi:

Rekomandime

Ekipi i rishikimit identifikoi rekomandimet e mëposhtme:

- UAMD-ja duhet të publikojë në internet syllabuset për të gjitha programet e tij të studimit për të bërë të mundur që stafi, studentët dhe studentët e ardhshëm të njihen me këtë informacion. **[Kapitulli I Standardi I.6]**

Konfirmime

Ekipi i rishikimit konfirmoi veprimin e mëposhtëm në procesin e zbatimit:

- Ekipi i rishikimit nuk identifikoi ndonjë veprim në proces.

Gjykim

Standardet për kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: mësimdhënia, të mësuarit, vlerësimi dhe kërkimi

- 4.1 UAMD-ja organizon programet e tij të studimit bazuar në ligjin për arsimin e lartë, statutin, rregulloren, rregulloret e fakulteteve, kurrikulat dhe syllabuset **[A.E101]**. Është deklaruar se stafi i UAMD-së është i përfshirë në trajnime, projekte dhe bashkëpunime ndërkombëtare, gjë që ka ndikuar në përmirësimin e përgatitjes së kurrikulave në programe të ndryshme studimi **[RVV, f. 38; BM2; BM6]**. Megjithatë, grupi i vlerësimit është i mendimit se UAMD-ja duhet të jetë më e përkushtuar ndaj projekteve tipike kërkimore dhe trajnimeve mësimore shtesë. Gjithashtu, deklarohet se Universiteti menaxhon ngarkesat e stafit në mënyrë të përshtatshme duke balancuar punën mësimore, kërkimore dhe administrative **[A.E80]**, por shumica e stafit akademik janë të përfshirë në mësimdhënie dhe shumë më pak në kërkime, edhe pse janë ngritur grupe kërkimore **[BM6]**. Gjithashtu, deklarohet se UAMD-ja ka mjedise të mjaftueshme, hapësirë logjistike dhe akademike për të zbatuar ofertën e tij akademike duke përmbushur kriteret e përcaktuara **[A.E9; RVV, f. 38]**. Pavarësisht hapësirës së mjaftueshme, veçanërisht në kampusin e Spitallës, nevojiten më shumë pajisje për kryerjen e praktikave mësimore, pasi në raport me numrin e studentëve ato janë të pakta **[BM3]**. Situata pandemike ka bërë që disa praktika laboratorike të zhvillohen në internet **[BM3]**. Për të përgatitur më mirë studentët në aspektin praktik, në programet e studimit BSc dhe MSc duhet të bëhet më shumë punë praktike **[BM3; BM4]**. Studentët dhe stafi hyjnë lehtësisht në bazat e të dhënave të bibliotekës dhe bazuar në marrëveshjen me JStore kanë mundësi të përdorin burime elektronike shtesë **[A.E102; BM3; BM4]**. Gjatë situatës së pandemisë, UAMD-ja ndoqi një politikë të veçantë në mbështetje të studentëve për lehtësimin e procesit mësimor si dhe atë të kontrollit të njohurive **[A.E103; BM3]**. Megjithatë, UAMD-ja duhet të mendojë seriozisht për të përmirësuar sistemin Pitagora në të ardhmen, në mënyrë që stafi akademik të vendosë aty materialet e ndryshme për studentët që ata ta përdorin sistemin në dobi të tyre **[BM4]**. **[Kapitulli I Standardi II.1]**.
- 4.2 Rregullat dhe kërkesat për provimin e diplomimit miratohen nga strukturat përgjegjëse të universitetit dhe u bëhen të njohura të gjithëve nëpërmjet rregullores. Në UAMD, studentët mund të diplomohen pas përfundimit të suksesshëm të provimeve të parashikuara në programin e studimit dhe të marrin titullin përkatës nga institucioni. Të gjitha provimet e zhvilluara bazohen në Rregulloren e UAMD-së **[A.E2]**. Megjithatë, disa nga studentët e anketuar në kuadër të këtij vlerësimi raportuan se provimet online lënë më shumë mundësi për të kopjuar në krahasim me provimet fizike **[BM3]**. Diplomimi kryhet nëpërmjet mbrojtjes së tezës ose me provimin e përgjithshëm përfundimtar (neni 75 "Mbrojtja e tezës", neni 76 "Marrja e diplomës"). Gjithashtu, këto rregulla janë hartuar në zbatim të pikës VIII të syllabuseve, nën titullin "Mënyra e vlerësimit". Programi i prezantohet studentit në javën e parë të vitit të ri akademik. Këtë e deklaruan edhe studentët **[BM3; BM4]**, por në syllabus metoda e vlerësimit të studentëve nuk përshkruhet në detaje dhe nuk është e qartë **[A.E101]**. Procedurat për përzgjedhjen, përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës, si dhe organizimin dhe vlerësimin e provimit përfundimtar të diplomimit të përgjithshëm bazohen në Rregulloren e UAMD-së **[A.E2, neni 75 dhe 76]**. Studentët dhe stafi akademik mbështeten në rrafshin administrativ nga strukturat e sekretarive në nivel të njësisë kryesore **[BM3; BM4]**. Të gjitha të dhënat e studentëve regjistrohen në Regjistrat Bazë dhe në Regjistrin e Arritjeve Akademike bazuar në Rregulloren e UAMD-së **[A.E2, neni 89]**. Në përfundim të studimeve për të gjithë studentët, UAMD-ja lëshon diploma ose certifikata.

Elementët përbërës, lloji i diplomës dhe procedurat e regjistrimit caktohen nga Ministria përgjegjëse për arsimin. Diplomat e lëshuara janë: Diploma profesionale; Diploma e ciklit të parë “Bachelor”; Diploma e ciklit të dytë “Master profesional”; Diploma e ciklit të dytë “Master i shkencave”; Diploma për gradën shkencore “Doktor”, ku për momentin ka vetëm një student, i cili mori pjesë në takimin me ekipin e rishikimit **[BM5]**. Diplomat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë shoqërohen me suplementin e diplomës dhe ky i fundit hartohet në përputhje me kërkesat e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë **[A.E14]**. Gjithashtu, forma dhe specifikat e suplementit përcaktohen në Rregulloren e UAMD-së në përputhje me udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse për arsimin **[A.E2] [Kreu I Standardi II.2]**.

4.3 UAMD-ja është e angazhuar vazhdimisht në përmirësimin e programeve të studimit dhe kjo është bërë në vitin 2018 në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Përmirësimi i programeve të studimit kryhet në mënyrë periodike me synim rritjen e performancës akademike të institucionit **[BM10]**. Ky proces kryhet nëpërmjet ndryshimeve periodike të kurrikulave, në bazë të propozimit të departamentit, ndryshimeve periodike të syllabusit të lëndëve, të cilat miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të vitit akademik në bazë të Rregullores së UAMD-së **[A.E2, neni 62]**. Gjithashtu, UAMD-ja është angazhuar në trajnimin e stafit, përmirësimin e ambienteve, lëvizshmërinë akademike **[A.E6]** dhe rritjen e numrit të librave të përkthyer për studentët, bazuar në marrëveshjen ndërmjet UAMD-së dhe AADF-së përmes së cilës deri më tani janë përkthyer tre libra **[BM7]**. E rëndësishme është se cilësia e programeve të studimit dhe përshtatja e tyre me tregun e punës vlerësohet edhe nga statistikat e punësimit të të diplomuarve, të përpiluara nga Zyra Alumni **[A.E104]**. Për sa i përket kontrollit të cilësisë dhe rritjes së cilësisë akademike, UAMD-ja aplikon disa mekanizma vlerësimi si: vlerësimi i studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe efektivitetin e programeve të studimit **[A.E105; BM3; BM4]**. Në lidhje me këtë, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Regjistrave është përgjegjëse për monitorimin e procesit të anketimit. Studentët plotësojnë pyetësorët, por nuk informohen për rezultatet, çka nuk është transparente **[BM4]**. Gjithashtu, UAMD-ja harton raportet e vetëvlerësimit dhe raportet e vlerësimit nga drejtuesi i njësisë kryesore **[A.E80]**. UAMD-ja zotëron njësi infrastrukturore që mbështesin inovacionin në mësimdhënie **[A.E99]**. Programi i studimit përbëhet nga aktivitete formuese, të cilat realizohen me kredi **ECTS** për të lehtësuar integrimin e të diplomuarve të UAMD-së në tregun e punës (ofrohet edhe konvertimi në kredite amerikane). Lëndët me zgjedhje dhe praktikat e mësimdhënies janë pjesë e kurrikulës së çdo programi studimi, ndërsa praktikat e mësimdhënies kryhen në përputhje me përcaktimet e rregulloreve përkatëse të Njësisë Bazë **[A.E106]**. Praktika Profesionale është pjesë e kurrikulave të Studimeve të Larta Profesionale, Cikli i Parë dhe i Dytë i studimeve që miratohen nga Njësia Bazë në përputhje me llojin dhe ciklin e studimit si dhe veçoritë e programit të studimit. Për realizimin e praktikave të mësimdhënies UAMD-ja ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh në nivel institucional, fakultete dhe departamente **[A.E72]**. UAMD-ja ka shtuar ndjeshëm praktikat e studentëve në katër vitet e fundit **[BM2]**. Pavarësisht kësaj, në disa njësi duhet të shtohen orët e praktikës profesionale bazuar në programin e studimit, pasi disa praktika janë të shkurtra **[BM4] [Kapitulli I Standardi II.3]**.

4.4 UAMD-ja ka hartuar një politikë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, dhe përgjegjësia për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies është e institucionalizuar në strukturat përkatëse, të tilla si: Drejtoria e

Administratës dhe Shërbimeve Akademike, Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, si dhe Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë **[A.E7]**. Gjithashtu, përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies është në fokus të mbështetjes institucionale nëpërmjet inovacionit në mësimdhënie, krijimit të njësive inovative të infrastrukturës si Laboratori i Multimedias dhe i Gjuhëve të Huaja, ose Laboratori i Teknologjisë së Automobilave **[RVV, f. 41; Vizitë në mjediset universitare]**. Më tej, për të përmirësuar cilësinë, UAMD-ja inkurajon dhe mbështet financiarisht stafin për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme si konferenca apo punë kërkimore jashtë vendit **[A.E107; BM2; BM6]**. Megjithatë, buxheti për vitin 2021 nuk parashikon fonde të mjaftueshme për kërkimin shkencor, dhe në takime të ndryshme na është deklaruar se shuma për kërkime dhe botime është rreth 50.000 Euro **[A.E107; BM2; BM6]**. Në këtë situatë, është shumë inkurajues fakti që buxheti i kërkimit vitin e ardhshëm do të rritet me 75% **[BM2]**. Kualifikimi i vazhdueshëm i personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor realizohet përmes projekteve dhe trajnimeve profesionale, si dhe trajnimit të personelit akademik. Në të ardhmen duhet të rritet numri i trajnimeve profesionale dhe projekteve kërkimore. Gjatë viteve 2016-2020, 45 pedagogë të UAMD-së janë trajnuar nga partnerë ndërkombëtarë për përmirësimin e kapaciteteve. Vetëm përmes projektit TEAVET, 32 anëtarë të stafit akademik të universiteteve partnere janë trajnuar për 16 module trajnimi online **[RVV, f. 41; B.M6]**. Ekipit të vlerësimit të jashtëm iu tha se stafi akademik trajnohet vazhdimisht për përmirësimin e mësimdhënies përmes pjesëmarrjes në trajnime brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të projekteve në të cilat UAMD-ja është partner **[RVV, f. 41, 46]**, por këto nuk janë të dokumentuara. Po ashtu, na u tha edhe se UAMD-ja ka planifikuar trajnime për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, dhe se këto trajnime bazohen kryesisht në projekte të ndryshme. Ekipi i vlerësimit sugjeron që Qendra për Edukimin e Vazhduar të planifikojë më shumë trajnime për stafin e UAMD-së dhe trajnerët e stafit, si dhe të ofrojë trajnime shtesë për metodat e reja të mësimdhënies dhe veçanërisht për mësimdhënien online. Monitorimi dhe kontrolli i ecurisë dhe cilësisë së mësimdhënies kryhet nga Përgjegjësi i Departamentit, në bazë të plotësimit të formularit të vlerësimit dhe ky vlerësim depozitohet në Njësinë Kryesore **[A.E80]**. Gjithashtu, zyra/dega e mësimdhënies është përgjegjëse për vlerësimin e performancës mësimore, bazuar në vlerësimin e studentëve për performancën e pedagogëve, dhe ky proces kryhet automatikisht përmes projektit Clean Score, çka maksimizon vërtetësinë e gjetjeve **[A.E105]**. Gjithashtu, procesi i anketimit, i cili ndiqet nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Regjistrave, kryhet në përputhje me formularët e miratuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, siç parashikohet në Rregulloren e UAMD-së. Të gjithë pedagogët që marrin një rezultat nën 70% nga vlerësimi i studentëve duhet t'i nënshtrohen trajnimit në qendrën e trajnimit **[BM10]**. Procesi i mësimdhënies në funksion të programeve të studimit zhvillohet në godinën qendrore në Currila dhe kampusin universitar në Spitalë **[Vizitë e mjediseve]** **[Kapitulli I Standard II. 4]**.

- 4.5 UAMD-ja ka gjithsej 23 Departamente, ose njësi akademike bazë, të cilat grupohen sipas disiplinave përkatëse mësimore dhe në fillim të çdo viti akademik përcaktojnë fushat, drejtimet, ngarkesën dhe afatet e veprimtarisë kërkimore-shkencore **[RVV, f. 41; BM9]**. Në përputhje me fushat e kërkimit shkencor, disiplinat, profilet dhe ciklet e studimit, Departamenti propozon ekipe mësimore dhe kërkimore. Në mbledhjet e departamentit propozohet ndarja e ekipeve kërkimore-mësimore si dhe e pedagogëve përkatës, duke iu referuar kryesisht profilit dhe vijimësisë së studimeve si dhe preferencës **[A.E108]**. UADM-ja harton Planin Buxhetor Afatmesëm (PBA) në mënyrë

sistematike dhe në bazë të kërkesave të departamenteve përkatëse **[A.E109]**. Në këtë plan përfshihet aplikimi për projekte me karakter rajonal dhe kombëtar, duke bërë të mundur që çdo departament të aplikojë për projekte kërkimore-shkencore, bazuar në grupet kërkimore dhe prioritetet kërkimore përkatëse **[RVV, f. 41]**. Megjithatë, departamentet nuk kanë fonde specifike, dhe buxheti është i centralizuar **[BM9]**. Gjithashtu, njësitë bazë aplikojnë për projekte kërkimore infrastrukturore pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Ekipi i vlerësimit u bë me dije se praktika e të shkruarit dhe konkurrimit përmes projekteve në nivel kombëtar ka çuar në rritjen e kapaciteteve për të aplikuar me sukses edhe në arenën ndërkombëtare **[RVV, f. 42; C.E5]** dhe se këto arritje janë pjesë e strategjisë e cila synon ndërkombëtarizimin e universitetit **[A.E6]**.

Stafi kërkimor në UAMD vlerësohet periodikisht në baza vjetore, nëpërmjet të cilit pedagogu deklaron, ndër të tjera, ecurinë e kërkimit shkencor dhe planet për të ardhmen e afërt **[A.E80]**. Megjithatë, personeli akademik shpenzon pjesën më të madhe të kohës së tij të punës duke dhënë mësim, në raportin 60% mësimdhënie dhe 40% punë kërkimore **[BM6]**. Departamenti ndjek dhe monitoron kërkimin shkencor bazuar në raportet periodike që duhet të dorëzojë personeli akademik në përputhje me lirinë akademike, e cila shprehet në lirinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, krijimit dhe të drejtës së përdorimit të burimeve materiale dhe financiare në favor të realizimit të programit të studimit **[RVV, f. 42]**. Liria akademike bazohet në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren, Statutin e UAMD-së dhe parimet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. Veprimtaria kërkimore-shkencore në UAMD pasqyrohet përmes raportit vjetor të analizës së kërkimeve të Universitetit 2018-2019 **[A.E22; A.E52]**. Është faktor nxitës fakti që UAMD-ja ofron mbështetje financiare shtesë për stafin akademik që publikon punime në revista ndërkombëtare me faktor impakti **[BM9]**. Gjithsesi, nga takimet me stafin akademik vetëm një grup kërkimor është shpallur fitues i një projekti nga buxheti i UAMD-së, por nuk ka mundur të realizohet për shkak të vonesave në pagesa dhe situatës pandemike **[BM10]**. Pas vizitës së ekipit vlerësues në UAMD, na u dorëzua një listë e projekteve kërkimore në proces nga viti 2020, me shumë totale 32.000 Euro, të cilat nuk u përmendën gjatë takimit me stafin akademik, me përjashtim të njërit prej projekteve **[C1; BM6; BM7; BM9; BM10; BM12]**. Kryesisht UAMD-ja zbaton projekte për ngritjen e kapaciteteve **[BM9]**, të cilat fokusohen në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve, përmirësimin e kapaciteteve të infrastrukturës, nëpërmjet krijimit të laboratorëve të dedikuar për këtë qëllim, si dhe në shkëmbimin e vizitave studimore ndërmjet partnerëve **[Kapitulli II Standard I. 1]**.

- 4.6 UAMD-ja mirëpret dhe inkurajon propozimet kërkimore që janë në përputhje me misionin dhe fushat e veprimtarisë të parashikuara në Rregulloren e tij, si dhe me fushat parësore të identikuara nga NASRI **[A.E2, neni 30, pika 2]**. Gjithashtu, ai i kushton vëmendje të veçantë grupeve dhe projekteve të reja kërkimore-shkencore të bazuara në PBA dhe u përgjigjet thirrjeve për projekte infrastrukturore në fushën e kërkimit shkencor, të cilat vijnë periodikisht nga NASRI, ose institucione të tjera **[A.E110; BM9]**. Edhe pse UAMD-ja ka aplikuar për disa projekte, ato janë kryesisht për ngritjen e kapaciteteve **[C5; BM7; BM9]**. UAMD-ja i mundëson stafit akademik, njësitë bazë, apo studentëve të drejtën për të aplikuar për fonde pranë institucioneve kombëtare apo ndërkombëtare për realizimin e veprimtarisë kërkimore dhe krijuese bazuar në Rregulloren e UAMD-së **[A.E2]**. Megjithatë, në përgjithësi, aplikimet për

projekte kërkimore janë të pakta nga stafi akademik. Janë bërë katër aplikime dhe dy janë fituar, ndërsa studentët rrallë përfshihen në këto aplikime **[BM7; B.M3; BM4]**. Gjithashtu, UAMD-ja siguron bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore në funksion të dinamizimit të kërkimit shkencor. Për këtë UAMD-ja ka nënshkruar 55 marrëveshje ndërkombëtare dhe kombëtare me Institucionet e Arsimit të Lartë **[A.E23]**. Aktualisht, universiteti është pjesë e tetë projekteve ndërkombëtare Erasmus+, në dy prej të cilave është lider. UAMD-ja ka marrëveshje bashkëpunimi me 102 institucione kombëtare, si DAR Durrës, Këshilli i Qarkut Durrës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës, Shoqata Shqiptare e Turizmit, etj. **[A.E23; A.E51]**. Por pavarësisht këtyre, gjendja nuk është shumë e kënaqshme sa i takon përmirësimit të vazhdueshëm të punës kërkimore. Na u tha se UAMD-ja mbështet kërkimin shkencor nga pedagogët nëpërmjet financimit të pjesëmarrjes së tyre në konferenca jashtë vendit si dhe mbështet kërkimin shkencor nga studentët nëpërmjet organizimit të konferencave studentore, workshopeve, start up-eve, etj. **[RVV, f, 42]; [A.E107]**. Ekipi i vlerësimit konstaton se studentët mbështeten për konferenca studentore, por jo për start up-e, ndoshta për shkak të situatës së pandemisë **[BM3; B.M4] [Kapitulli II Standardi I.2]**.

4.7 Për të zgjeruar ndërkombëtarizimin e kërkimit, UAMD-ja punon intensivisht nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, duke filluar nga pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare, si Erasmus+ **[A.E111]**, mobiliteti akademik, studentor dhe administrativ. Megjithatë, mobiliteti i studentëve është shumë i vogël në krahasim me numrin e studentëve **[A.E62; BM2; BM7]**. Gjithashtu, UAMD-ja është anëtare në rrjete të ndryshme si Agjencia e Universiteteve Frankofone (FUA), Shoqata e Universiteteve Evropiane (EUA), Magna Charta Universitatum; Unioni i Universiteteve Mesdhetare (UNIMED); Shoqata e Universiteteve Ballkanike (BUA); Program shkëmbimi me Evropën Qendrore dhe Lindore (CEEPUS). Është shumë inkurajuese që UAMD-ja organizon konferenca ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor **[www.uamd.edu.al]**. Stafi akademik i UAMD-së merr pjesë aktive në konferenca apo aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor, të cilat organizohen nga Universitete të rëndësishme evropiane dhe më gjerë **[A.E52]**. Për të zgjeruar ndërkombëtarizimin e kërkimit, UAMD-ja prezanton profilin e tij akademik në panairët ndërkombëtare të Arsimit të Lartë, zhvillon takime dypalëshe për gjetjen e partnerëve të mundshëm, si dhe nënshkruan marrëveshje partneriteti me institucione të huaja të arsimit të lartë. Ekipi i vlerësimit u bë me dije se UAMD-ja i kushton vëmendje të veçantë publikimit të punimeve kërkimore-shkencore të stafit të tij akademik në revista shkencore ndërkombëtare, me ISSN, Scopus, dhe Factor Impakti **[RVV, f, 43]**, por numri i këtyre publikimeve është i kufizuar **[BM9]**. Në të ardhmen, duhet të bëhen përpjekje të konsiderueshme për të rritur numrin e botimeve në revista me faktor impakti **[A.E52]**. Së shpejti, UAMD-ja synon të hapë programe të përbashkëta studimi dhe të lëshojë diplomave të dyfishta, që është objektiv strategjik i zhvillimit të institucionit **[A.E112] [Kapitulli II Standard I.3]**.

4.8 Prioritetet e kërkimit në UAMD varen nga disa faktorë, si profili i ekspertizës së universitetit dhe Plani Strategjik i Zhvillimit. Ato bazohen në prioritetet e fakulteteve dhe departamenteve, të shprehura në Strategjinë e Kërkimit të Fakultetit në përputhje me prioritetet shkencore të çdo departamenti, zhvillimet aktuale dhe tregun e punës **[A.E4]**. Kjo u vërtetua edhe në takimet me stafin akademik **[BM6; BM9]**. Përcaktimi i prioriteteve shkencore kryhet nëpërmjet diskutimit shkencor në nivel departamenti **[A.E1, neni 19, pika 2,3,5; neni 21 dhe 22; BM6]**. Këshilli i Kërkimit Shkencor ka si objektiv ta ridrejtojë universitetin drejt kërkimit shkencor **[A.E20]**. Për të arritur

prioritetet kërkimore, UAMD-ja ka praktika të mira në mbështetjen e inovacionit, si p.sh. pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare dhe seminare promovuese për idetë inovative të studentëve si: Start up-et e Departamentit të Menaxhimit (Fakulteti i Biznesit) apo workshopet e ndryshme, etj. **[A.E63]**. UAMD-ja duhet t'i japë jetë debatit shkencor në fushat parësore të kërkimit shkencor nëpërmjet organizimit të ditëve akademike, leksioneve të hapura, diskutimeve të leksioneve të reja në departamente dhe seminare ku stafi akademik mund të angazhohet në diskutimin e ideve dhe arritjeve shkencore. Gjithashtu, duhet të rritet numri i pedagogëve të huaj të cilët mund të sjellin metoda të reja kërkimi **[Kapitulli II Standardet I.4]**.

4.9 Departamentet dhe qendrat kërkimore të UAMD-së udhëheqin prioritetet kërkimore dhe stafi mbështetet financiarisht për të marrë pjesë në konferencat shkencore **[A.E107]**. Koha e kërkimit shkencor llogaritet në ngarkesën vjetore të punës të çdo anëtarit të stafit (**raporti i orëve mësimore**). Stafit i kërkohet gjithashtu të marrë pjesë të paktën në tre konferenca ndërkombëtare çdo vit ose të botojë artikuj në revista ndërkombëtare **[RVV, f. 43-44]**, por nuk është e qartë se në cilën platformë mund të botohen punimet ndërkombëtare. Për zbatimin e prioritetëve të tij kërkimore shkencore, UAMD-ja punëson staf akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor, në funksion të strategjisë së zhvillimit të institucionit, në përputhje me Rregulloren e Universitetit dhe Statutin e UAMD-së **[A.E78]**, ndërsa për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, UAMD-ja ka angazhuar pedagogë me kohë të pjesshme nga universitete të tjera shtetërore dhe specialistë të fushave të ndryshme. Universiteti organizon konferenca, simpoziume, kongrese dhe seminare të ndryshme në bashkëpunim me IAL-të e tjera dhe njësitë e tyre. UAMD-ja ka ngritur dhe përmirësuar vazhdimisht infrastrukturën në mbështetje dhe funksion të veprimtarisë kërkimore-shkencore, por ajo nuk është e mjaftueshme për kërkimin shkencor dhe për të gjeneruar të ardhura. Përveç kësaj, UAMD-ja boton revistën e vet shkencore, e cila pasqyron zhvillimet më të fundit doktrinale, kërkimore-shkencore. Revista shërben edhe si pjesë e bibliografisë për kurset e zhvilluara në njësitë e UAMD-së. Megjithatë, nevojitet më shumë angazhim në drejtim të kërkimit **[Kapitulli II Standard I.5]**.

4.10 Për zhvillimin e qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të kërkimit shkencor, UAMD-ja zbaton disa praktika: përcaktimin e prioritetëve kërkimore **[A.E4]**, kriteret për vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe njësitë të UAMD-së **[Vendimi nr. 3, datë 30.04.2018 i Këshillit të Kërkimit Shkencor]**, matjen e performancës akademike të personelit, si dhe krijimin e "Bazës së të Dhënave të Kërkimeve Shkencore" **[A,E82]**. Për të matur cilësinë bazuar në treguesit kombëtarë, institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organet më të rëndësishme shkencore **[A,E23]** ose aderon në rrjetet ndërkombëtare, si Shoqata e Universiteteve Ekonomike të Evropës Jugore dhe Lindore dhe Rajonit të Detit të Zi (ASECU). UAMD-ja ka bërë përpjekje për institucionalizimin e një politike të favorshme për përfshirjen e studiuesve të rinj në projekte kërkimore, e cila shprehet përmes përfshirjes së studentëve të ciklit të dytë në veprimtarinë kërkimore-shkencore, nëpërmjet përzgjedhjes së temave për mbrojtjen e tezave në fushat prioritare të Fakultetit, përfshirjen e studentëve të ciklit të dytë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, bashkëpunimet mes pedagogëve dhe studentëve të ciklit të dytë në punime të përbashkëta shkencore dhe organizimi i konferencave studentore. Megjithatë, përfshirja e studentëve nuk është shumë e lartë dhe në të ardhmen duhet të përfshihen më shumë studentë në projekte kërkimore dhe konferenca kombëtare e ndërkombëtare **[BM3; BM4]**. UAMD-ja zbaton disa projekte rajonale që lidhen me fushat prioritare të politikave shkencore rajonale dhe kombëtare.

Nëpërmjet projekteve ndërkombëtare të zbatuara nga UAMD-ja kanë përfituar edhe partnerë vendorë dhe kombëtarë të UAMD-së, si TEAVET (Developing TEACHER Competences for a Comprehensive VET System in Albania) nëpërmjet të cilit janë akredituar module për trajnimin e mësuesve të shkollave parauniversitare. Në vitin e parë të projektit janë krijuar tetë qendra trajnimi me modele të akredituara nga IZHA (Instituti i Zhvillimit të Arsimit). E fundit, por jo për nga rëndësia, në kuadrin e ndërkombëtarizimit të studimeve, UAMD-ja ndjek një politikë të favorshme për mobilitetin e stafit. Megjithatë, nuk është e qartë pse nuk ka anëtarë të stafit akademik të UAMD-së që të jenë lektorë apo anëtarë të grupeve kërkimore në universitete të huaja. Për të nxitur rritjen e cilësisë dhe ndërkombëtarizimin e studimeve, UAMD-ja duhet të shtojë numrin e stafit akademik të huaj për të marrë pjesë në mësimdhënie në formën e leksioneve të hapura dhe angazhimeve me kohë të pjesshme. Qendra për Kërkim dhe Ekselencë nuk ka buxhetin e vet dhe kjo e ndërlikon punën e saj **[BM9]**. Megjithatë, kjo qendër duhet të përgatisë një plan se si të përfshihet i gjithë stafi akademik në projekte shkencore, pasi numri i personelit në këtë qendër është i vogël për të funksionuar mirë dhe stafi duhet të trajnohet veçanërisht për aplikim në fondet e BE-së **[Kapitulli II Standardi I.6]**.

- 4.11 UAMD-ja publikon punime shkencore, organizon konferenca ndërkombëtare, leksione të hapura dhe seminare akademike **[A.E113; A.E114]**. Edhe pse UAMD-ja organizon disa uorkshope dhe seminare, numri i pedagogëve të huaj nuk është i lartë sa duhet dhe ka nevojë të rritet për të sjellë metoda të reja kërkimi. Ekipit të vlerësimit iu deklarua se universiteti ka buxhet për organizimin e konferencave shkencore **[RVV, f. 44; A.E.33]**, por nga dokumentet nuk mund të verifikohet se sa është ky buxhet. Rezultatet e kërkimit nga stafi akademik i UAMD-së publikohen edhe në revistat vendase, "Interdisciplinary Journal of Research and Development", www.uamd.edu.al. Aktet e Konferencave Shkencore që organizohen periodikisht në secilin prej Fakulteteve publikohen në www.uamd.al, po ashtu edhe Aktet e Konferencave Studentore. Gjithashtu, UAMD-ja organizon aktivitete të përbashkëta shkencore me struktura të tjera të kërkimit shkencor, përfshirë Buletinin e UAMD-së dhe Botimin e Broshurave, megjithatë, **kjo nuk mjafton. Duhet të bëhen më shumë botime në revista të huaja dhe me faktor impakti**. Sa i takon plagjiaturës, është përcaktuar një numër i caktuar fjalësh dhe çdo punim prej mesatarisht 35 faqesh kontrollohet **[BM2]**, por pavarësisht kriterëve kundër plagjiaturës, nuk është e qartë se sa funksionale janë ato **[Kapitulli II Standardet I.7]**.
- 4.12 UAMD-ja kryen vlerësime vjetore të rezultateve shkencore dhe i paraqet ato në Analizën Vjetore të Fakulteteve **[A.E115]**. Ky është një tregues se të gjitha fakultetet përdorin të njëjtin sistem matjeje të unifikuar. Deri më tani, transferimi i rezultateve shkencore bëhet për dy objektiva kryesore: përfshirjen e studiuesve të rinj në grupe kërkimore dhe së dyti, përmes partneriteteve me komunitetet e biznesit dhe subjektet profesionale, të cilat ofrojnë mundësi për transferimet shkencore, p.sh.: shembull: Marrëveshja e Bashkëpunimit TravelBest **[A.E72]**. Raporti thekson se publikimet janë gjithashtu një instrument tjetër, i cili përfshin revista ndërkombëtare të vlerësuara me faktor impakti **[RVV, f. 44; A.E.52; C6]**, por numri i revistave nuk është shumë i madh. UAMD-ja bashkëpunon me disa universitete brenda vendit dhe rajonit dhe ndjek një politikë të promovimit të arritjeve kërkimore, përfshirë organizimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore. UAMD-ja, gjithashtu, organizon leksione të hapura, seminare ndërkombëtare, simpoziume shkencore dhe forume akademike **[A.E77; C9]**, por duhet të rrisë numrin e këtyre aktiviteteve. Me gjasë, në dy vitet e fundit, për shkak të

pandemisë, UAMD-ja nuk ka pasur asnjë pedagog të huaj **[Kapitulli II Standardet I.8]**.

Gjetjet

Praktika e mirë

- Ekipi i rishikimit nuk identifikoi ndonjë element të praktikës së mirë.

Dobësitë

Ekipi i rishikimit identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- UAMD ka mungesë financimi për projekte kërkimore – me përjashtim të mbështetjes për pjesëmarrjen në konferenca dhe mbulimit të tarifave të botimit – çka e pengon të ndërmarrë kërkime me cilësi të lartë, të cilat finalizohen me botimin e artikujve shkencorë në revista me faktor impakti. **[Kapitulli I Standardi II.4 dhe Kapitulli II Standardi I.1]**

Rekomandime

Ekipi i rishikimit identifikoi rekomandimet e mëposhtme:

- UAMD-ja duhet të rishikojë periodikisht treguesit kryesorë të performancës, si numrin e regjistrimeve të reja, numrin total të studentëve, numrin e braktisësve, numrin e ish studentëve, listën e publikimeve, numrin e botimeve për profesor dhe të pasqyrojë këtë vlerësim në veprimet e ndërmarra. **[Kapitulli I Standardi II.1]**
- Stafi akademik i UAMD-së duhet të reflektojë mbi rezultatet e pyetësorëve të studentëve dhe të informojë studentët në mënyrë sa më të strukturuar në lidhje me gjetjet. **[Kapitulli I Standardi II.3]**
- UAMD-ja duhet të rrisë aplikimet për projekte kërkimore në thirrje kombëtare dhe ndërkombëtare për të rritur numrin e projekteve kërkimore ndërkombëtare dhe përfshirjen e studiuesve dhe studentëve të rinj. **[Kapitulli II Standardi I.1, I.6 dhe I.7]**
- UAMD-ja duhet të organizojë seminare periodike për stafin dhe studentët me fokus ndërgjegjësimin për plagjiaturën. **[Kapitulli II Standardet I.7]**

Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra

Ekipi i rishikimit konfirmoi veprimin e mëposhtëm tashmë në proces:

- Rritja e planifikuar me 75% e buxhetit të UAMD-së për projektet e vogla kërkimore për të cilat departamentet mund të aplikojnë është një zhvillim pozitiv që duhet të pasohet nga një rregullore që institucionalizon procesin **[Kapitulli II Standardi I.1]**
- Mbështetja e drejtpërdrejtë e UAMD-së për stafin akademik të angazhuar në botimin e artikujve kërkimorë në revista me faktor impakti është një praktikë pozitive që ka potencialin të rrijë një kulturë të shëndetshme akademike **[Kapitulli II Standardi I.1]**

Gjykim

Standardet për mësimdhënien, të nxënit, vlerësimin dhe kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimi 5: Studentët dhe mbështetja për ta

- 5.1 UAMD-ja zbaton procedurat për pranimin dhe transferimin e studentëve sipas ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe Vendimit nr. 36 Datë 20/04/2021 të Senatit Akademik **[A.E116]**. Kriteret dhe procedurat për pranimin në programet e studimit përcaktohen nëpërmjet propozimit të Njësive Bazë dhe miratimit të Senatit Akademik **[A.E50]**, dhe garantojnë mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët përmes një procesi transparent të vlerësimi dhe përzgjedhjes së aplikantëve. Për disa kategori të veçanta, si studentët shqiptarë nga Kosova, Maqedonia e Veriut etj., pakicat kombëtare, të rinjtë me statusin e jetimit dhe personat me aftësi të veçanta, parashikohen kuota të posaçme **[A.E116]**. Studentët informohen për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të tyre të studimit që në momentin e regjistrimit **[BM3; BM4]** dhe krahas kësaj, kandidatët e Departamentit të Studimeve të Integruara me Praktikën (DESTIP) i nënshtrohen edhe testit të pranimit dhe të gjuhës angleze që zhvillohet nga kompania partnere nën mbikëqyrjen e departamentit, sipas dispozitave përkatëse **[RVV, f. 47]**. UAMD-ja informon maturantët për programet e studimit nëpërmjet organizimit të aktiviteteve që kanë në fokus këshillimin dhe orientimin në karrierë për maturantët si: Ditët e hapura (Aktivitet e karrierës nëpër shkolla) si dhe Panairi: "Ditët e orientimit për karrierë të maturantëve" [\[https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/2021/03/31/ditet-e-informimit-te-maturanteve/\]](https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/2021/03/31/ditet-e-informimit-te-maturanteve/). Në këto aktivitete, përfaqësuesit e institucionit ofrojnë këshillim dhe orientim për maturantët e interesuar për programet e studimit dhe mënyrat e aplikimit. Kjo gjë u konfirmua edhe nga studentët **[BM3; BM4]**. Për të informuar sa më shumë maturantë për programet e studimit, kriteret e pranimit dhe mënyrën e aplikimit në UAMD, universiteti e publikon informacionin në faqen zyrtare të internetit [\[https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/2021/05/04/zshe-departamentin-e-shkencave-te-aplikuara-dhe-te-natyres-ne-uamd/\]](https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/2021/05/04/zshe-departamentin-e-shkencave-te-aplikuara-dhe-te-natyres-ne-uamd/) dhe shpërndan gjerësisht materiale informative si fletëpalosjet **[A.E96] [Kapitulli I Standardi III.1]**.
- 5.2 UAMD-ja ka përgatitur një udhëzues për studentët dhe në fillim të çdo viti akademik studentët informohen për kalendarin akademik, strukturën administrative, shkëmbimin e studentëve, jetën shoqërore, klubet studentore etj. **[A.E84]**. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës pranë Degës së Këshillimit Studentor ndihmon në orientimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve. Gjatë pandemisë, ky sektor organizoi një webinar për këshillimin e studentëve në lidhje me karrierën **[A.E60; https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/2020/04/20/uamd-organizon-uebinar-per-keshillim-karriere/]** si dhe takime informuese për hartimin e CV-ve, letrave motivuese dhe letrave të interesit **[A.E117]**. UAMD-ja mban kontakte me ish studentët nëpërmjet Rrjetit Alumni dhe kompanive të ndryshme publike dhe private për praktikën e studentëve, zhvillimin e kurrikulave dhe mundësi punësimi për studentët aktualë dhe ish studentët **[A.E104; A.E23; BM7; BM11]**. Megjithatë, nuk ka dëshmi materiale për mbajtjen e takimeve të rregullta të rrjetit Alumni, pasi ato janë kryesisht takime

